

A N 2 1

RAPORT
VJETOR
KOMBËTAR

T I

K O R O

R U 2 1

2 P S I

2 O N I



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I MINISTRAVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTËR I SHTETIT PËR
STANDARDET E SHËRBIMEVE


2021

RAPORT VJETOR KOMBËTAR
PËR ANTIKORRUPSIONIN

DIGJITALIZIMI SI MJET EFEKTIV PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN

TIRANË, PRILL 2022

TABELA E PËRMBLIT



8 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

KAPITULLI 1



12 DIGJITALIZIMI SI MJET PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN

KAPITULLI 3




44 MEKANIZMAT E ANKESAVE DHE HETIMI ADMINISTRATIV I KORRUPSIONIT

3.1 Mekanizmat e ankesave digjitale dhe hetimi administrativ i korrupsionit

3.2 Hetimi i korrupsionit nga policia dhe mekanizmat e mbikqyrjes policore

KAPITULLI 4




56 PRAKTIKAT E MIRA PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE DHE NDËRGJEGJËSIMIN PËR KORRUPSIONIN NË EPOKËN DIGJITALE

4.1 Ngritja e mundësive

4.2 Ndërgjegjësimi

PËRMBAJTJES

KAPITULLI 2



18 DIGJITALIZIMI PËR PARANDALIMIN E KËRRUPSIONIT NË SEKTORËT KYÇ



2.1 Prokurimi Publik



2.2 Sektori Financiar



2.3 Kujdesi shëndetësor



2.4 Arsimi




2.5 Pronësia




2.6 Shërbimet e transportit rrugor


KAPITULLI 5



63 PËRMBLEDHJE & PËRFUNDIME



VËSHTRIM I
PËRGJITHSHËM





Lufta kundër korrupsionit është një nga përparësitë themelore të qeverisë shqiptare. Përparimi i arritur në zbatimin e agjendës kombëtare kundër korrupsionit është parakusht për forcimin e shtetit të së drejtës dhe përmirësimin e standardeve të jetesës për qytetarët shqiptarë. Në të njëjtën kohë, arritja e rezultateve konkrete në garantimin e qasjes, cilësisë, integritetit dhe transparencës së ofrimit të shërbimeve publike është kriter thelbësor për vlerësimin e punës së vendit në rrugën drejt Bashkimit Evropian.

Një nga shqetësimet kryesore të qeverisë shqiptare ishte të zbatonte dhe të garantonte përdorimin e gjerë të sistemeve elektronike të menaxhimit të të dhënave për të lehtësuar ndërtimin e një administrate shtetërore të paprekur nga korrupsioni përmes përpunimit, transmetimit dhe ndarjes automatike të informacionit në sektorin publik. Qëllimi i këtyre instrumenteve është të përmirësojnë mirëqeverisjen, të sigurojnë shërbime dhe politika më të mira, angazhime më elastike, efektive dhe të volitshme publike, besim më të lartë te qeveria, mirëqenie sociale dhe rezultate gjithpërfshirëse të politikave, si dhe rritje ekonomike. Në këtë mënyrë, vënia në përdorim e instrumenteve të TIK-ut për të ofruar shërbimet publike kontribuon në rritjen e besimit tek institucionet qeverisëse, ndërkohë që përmbush kërkesat në rritje të qytetarëve për transparencë, integritet, llogaridhënie.

Përveç zgjerimit të strukturës institucionale kundër korrupsionit, viti 2021 shënoi zhvillime të jashtëzakonshme sa i takon uljes së korrupsionit përmes riorganizimit të plotë të ofrimit të shërbimeve publike. Deri pak vite më parë, qytetarët shqiptarë i merrnin të gjitha shërbimet publike në sportele, një proces që shoqërohej me kosto të konsiderueshme në kohë dhe në para. Sot, revolucioni digjital në ofrimin e shërbimeve elektronike ka bërë të mundur që çdo shërbim të

merret në një kohë shumë më të shkurtër dhe pa pasur nevojë për të dërguar informacione shtesë, falë ndërlidhjes së bazave shtetërore të të dhënave, me qëllim ofrimin e këtij shërbimi. Paralelisht me këtë proces janë ngritur platforma të reja digjitale, të cilat krijojnë kapacitet për komunikim në kohë reale me qytetarët, si dhe gjurmojnë e mundësojnë zgjidhjen efikase të çështjeve. Ato përfshijnë Platformën e Bashkëqeverisjes, Regjistrin Elektronik të Ankesave të Prokurimit Publik, Komisarjatin Digjital etj.

Instrumentet kryesore të informacionit dhe teknologjisë që përdoren nga institucionet e qeverisë shqiptare përfshijnë shërbimet e digjitalizuara të shpërndarjes në publik, shërbimet e qeverisjes elektronike, sisteme të ndryshme informimi për pranime (shkolla, spitale, transport etj.), sisteme elektronike monitorimi, sisteme të prokurimit elektronik, sisteme të informacionit financiar, si dhe sisteme informimi dhe monitorimi. Në Shqipëri, digjitalizimi i ndërveprimeve të drejtpërdrejta që janë lehtësisht të automatizueshme midis qytetarëve dhe nëpunësve civilë është shtyllë e masave kundër korrupsionit. Kjo është arritur përmes uljes së ndërveprimeve ballë për ballë në ofrimin e shërbimeve në sektorin publik. Sistemet e sipërpërmendura automatike të shërbimeve shndërrohen në sisteme ofrimi të llojit me vetëshërbim. Më tej, instrumentet e qeverisjes

digjitale ndryshojnë formën e regjistrimit, praktikat e marrjes dhe vlefshmërisë së përgjithshme të të dhënave të prodhuara nga veprimtaria shtetërore.

Ofrimi i shërbimeve i menaxhuar në mënyrë digjitale lejon përmirësimin e monitorimit dhe hetimit të parregullsive, si dhe rrit efektivitetin dhe efikasitetin e dhënies së shërbimeve publike, përfshi afatet e ofrimit të këtyre shërbimeve, analizën e kostos për shërbim, kostot e prokurimeve etj. Në përgjithësi, automatizimi i ofrimit të shërbimeve publike ul burokracinë dhe hapësirën vendimmarrëse të zyrtarëve publikë, Komisioni i Prokurimit Publik boton buletine mujore dhe raporte të përvitshme që paraqesin të dhënat e prodhuara nga Sistemi i Ankesave Elektronike. Për të rritur transparencën dhe ndërgjegjësimin mbi instrumentet e vlefshme digjitale dhe funksionin e tyre, buletinet mujore u dërgohen të gjithë operatorëve ekonomikë të regjistruar në bazën e të dhënave të KPP-së dhe, po ashtu, vihen në dispozicion të publikut në faqen e internetit. Raportet vjetore përmbajnë statistika lidhur me ankesat e paraqitura përmes regjistrit elektronik, ecurinë e shqyrtimit të ankesave, si dhe vendimet e KPP-së lidhur me këto ankesa.

Ngritja dhe forcimi i institucioneve dhe

strukturave në luftën kundër korrupsionit, rritja e efikasitetit të ofrimit të shërbimeve, forcimi i kapaciteteve të administratës publike për t'u përballur me sfidat e luftës kundër korrupsionit kanë shënuar përparime vit pas viti. Përgjigjja efektive institucionale ndaj korrupsionit ka qenë objekt vlerësimi për një kohë të gjatë nga një sërë organizatash ndërkombëtare. Raporti i GRECO-s në Raundin e katërt të Vlerësimit, që përqendrohej në parandalimin e korrupsionit, pohoi se Shqipëria ka përmbushur plotësisht 9 nga 10 rekomandimet në këtë raund, si i vetmi vend në rajon që shënon arritjen e një rezultati të tillë pozitiv. Ndërkohë, Raporti për Shqipërinë i vitit 2021 i Komisionit Evropian, pavarësisht se thekson përparimet e bëra në forcimin e kuadrit strategjik ekzistues dhe kapacitetet e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, vlerëson se ka pasur ecuri në luftën kundër korrupsionit dhe se ka ende shumë sfida¹. Këto sfida përfshijnë kryesisht forcimin e kuadrit ekzistues institucional, ligjor e strategjik në luftën kundër korrupsionit, si dhe krijimin e një bilanci të fortë të hetimit dhe ndjekjes penale të rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Ecuria dhe sfidat në luftën kundër korrupsionit gjatë viteve të fundit në Shqipëri janë lidhur ngushtë me reformën në drejtësi, e cila ka hyrë

1. EC, Albania 2021 Report, Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, fq. 5, mund të aksesohet këtu: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

tashmë në fazën e konsolidimit. Falë gjithë punës ligjore dhe mbështetjes me dyfishimin e buxhetit për institucionet e drejtësisë këto pesë vitet e fundit, u bë i mundur funksionimi i plotë i të gjitha institucioneve të sistemit të drejtësisë, mbështetur në konceptet e integritetit dhe llogaridhënies. Arkitektura e re institucionale e sistemit të drejtësisë që i kushtohet posaçërisht luftës kundër korrupsionit, përfshi Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Byronë Kombëtare të Hetimit dhe gjykatat e posaçme kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit po e provon këtë nga dita në ditë. Kohës së pandëshkueshmërisë po i vjen fundi. Falë rezultateve të reformës në drejtësi, Shqipëria është sot në krye të vendeve të rajonit sa i takon hedhjes së themeleve të një drejtësie që rifiton besimin e qytetarëve.

Përveç ngritjes së të gjithë infrastrukturës së nevojshme për të hetuar dhe ndjekur penalisht korrupsionin, qeverisa shqiptare ka forcuar të gjitha strukturat institucionale, administrative dhe politikëbërëse kundër korrupsionit. Në tetor 2021, u krijua e para Drejtori e Përgjithshme kundër Korrupsionit pranë Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, me personel të dedikuar për parandalimin e korrupsionit, për ndëshkimin e tij dhe rritjen e ndërgjegjësimit në luftën kundër tij. Kjo strukturë, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e tjera, është përgjegjëse për të çuar përpara të gjithë kuadrin strategjik kundër korrupsionit. Në strukturimin e kësaj drejtorie, u është kushtuar vëmendje njësisë përgjegjëse për hetimin administrativ të praktikave abuzive dhe korruptive, vlerësimin e rrezikut të integritetit në institucionet publike, si dhe monitorimin e projekteve dhe programeve kundër korrupsionit. Po ashtu, gjatë vitit 2021, Rrjeti i Koordinatorëve Antikorrupsion u zgjerua nga 17 në 44 agjenci publike në nivel qendror dhe vendor, që vlerësohet se mbartin rrezik të lartë integriteti². Rrjeti përbëhet nga zyrtarë të emëruar në këto institucione, duke iu garantuar atyre varësinë e drejtpërdrejtë vetëm nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit dhe jo nga titullari i institucionit, me qëllim që të angazhohet në

hetimin e denoncimeve dhe të analizojë rrezikun e integritetit në këto struktura.

Ky raport shqyrton mënyrat në të cilat zbatohen dhe përdoren teknologjitë digjitale në punën e organizmave kundër korrupsionit në fushat me trysni dhe rrezik të lartë për integritetin. Fushat kryesore ku ai përqendrohet përfshijnë prokurimet publike, shërbimet e kujdesit shëndetësor, arsimit publik, dogana dhe tatimet, kadastra shtetërore dhe shërbimi civil. Shqyrtimi mbështetet në kontributet e ofruara nga organizmat kundër korrupsionit lidhur me përfitimet e digjitalizimit të shërbimeve publike sa i takon parandalimit, hetimit, mangësive në kapacitetet institucionale dhe nevojave për ndërgjegjësim në raport me korrupsionin.

Digjitalizimi ka prodhuar rezultate domethënëse në parandalimin e korrupsionit në sektorë kyç: numri i procedurave të negociuara pa shpallje paraprake është ulur ndjeshëm, duke shkuar nën 3,4 për qind në vitin 2021 nga 9,4 për qind që ishte në vitin 2018 dhe platforma “e-Complaint” për prokurimin publik është plotësisht funksionale. Përmes portalit qeveritar “e-Albania” ofrohen 99 për qind e të gjitha shërbimeve tatimore. Operatorët ekonomikë në Shqipëri mund të përftojë 34 nga 41 shërbime doganore elektronikisht dhe 52,5 për qind e shoqërive tregtare aktive janë të fiskalizuara.

Në sektorin shëndetësor, Certifikata e vaksinimit COVID-19, si pjesë e sistemit të integruar të BE-së, u lëshua që prej janarit 2021. Në fushën e arsimit, në vitin 2021 u shënuar një rritje prej 39 për qindësh e numrit të mësuesve të punësuar përmes portalit elektronik, krahasuar me vitin 2020. Mbi 1,5 milionë shërbime u ofruan në mënyrë digjitale nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe ka pasur një rritje me 67 për qind të certifikatave të pronësisë të lëshuara me firmë dhe vulë elektronike nga AKK-ja, krahasuar me vitin 2020

Sa u takon hetimeve, Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit rekomandoi marrjen e 85 masave administrative për zyrtarët e 8 institucioneve. Koordinatorit Kombëtar kundër

2. VKM nr. 618 Datë 20.10.2021 “Për krijimin dhe funksionimin e rrjetit të koordinatorëve kundër korrupsionit”

Korrupsionit i janë dërguar në rrugë digjitale 69 për qind e ankesave dhe denoncimeve. Në vitin 2021, Komisionatit Digjital iu shtuan dy rubrika për denoncimet lidhur me krimet mjedisore dhe dhunën në familje dhe policia e shtetit përfitoi qasje në 9 baza të reja të të dhënave, duke e çuar numrin e tyre në 60 gjithsej.

Gjatë vitit 2021, pavarësisht kufizimeve që diktoi pandemia, institucionet e administratës publike shqiptare, në bashkëpunim me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë, u përfshinë në trajnimin e personelit të tyre mbi praktikën kundër korrupsionit dhe kundër evazionit, si dhe në krijimin e instrumenteve të reja digjitale që shërbejnë për këtë qëllim, në organizimin e përbashkët të fushatës së ndërgjegjësimit kundër korrupsionit, “Java e integritetit” dhe ndërtimin e një platforme të re të ndërvëprimit digjital, “Denonco kadastrën”. Programet e ngritjes së kapaciteteve kundër korrupsionit që u drejttoheshin nëpunësve civilë (3 886 trajnime gjatë vitit 2021), u shtrinë te 31 471 tatimpagues dhe 3 433 ekspertë kontabël, si dhe në 1000 operatorë ekonomikë.

Mbi 410 000 pacientë në mbarë vendin që vuajnë nga sëmundje kronike dhe akute morën 3,9 milionë receta elektronike të lëshuara nga 1500 mjekë.

Digjitalizimi i procesit të lëshimit lejeve të drejtimit të automjeteve e shkurtoi kohën e pritjes nga 15-20 ditë në 30 minuta dhe i uli në zero kostot e verifikimit të lejes së drejtimit dhe autorizimit për rinovimin e lejes. Së fundi në radhë, por jo nga rëndësia, fiskalizimi i mbi 78% të të gjitha shoqërive tregtare aktive solli si rezultat lëshimin e mbi 22 milionë faturave në periudhën 1 janar 2021-27 shkurt 2022.

Falë kësaj ecurie, në Raportin mbi Parimet e Administratës Publike, OECD / SIGMA vërejti se Shqipëria ka shënuar përparim të qëndrueshëm në shumë sektorë, pavarësisht periudhës së pandemisë, duke u pozicionuar si kryesuese në rajonin e Ballkanit Perëndimor në të gjitha fushat kyçe³. Përdorimi i instrumenteve digjitale dhe teknologjive moderne ka treguar se digjitalizimi

është tejet i dobishëm për forcimin e përpjekjeve kundër korrupsionit, si dhe për të futur kulturën e integritetit në administratën publike shqiptare. Raporti i SIGMA-s vërteton se treguesi i vlerësimit për shërbimet digjitale në vitin 2021 u rrit me 3,8%, krahasuar me 3,3% që ishte në vitin 2017.

Përpjekjet e Shqipërisë për të rritur qasjen dhe cilësinë e shërbimeve publike ka sjellë rritje të përgjithshme të kënaqësisë nga ana e qytetarëve dhe bizneseve. Sipas Barometrit Ballkanik, në Anketën e Opinioneve Publike të zhvilluar në vitin 2021 nga Këshilli për Bashkëpunimin Rajonal, Shqipëria shënon nivelet më të larta të kënaqësisë lidhur me përdorimin e shërbimeve elektronike, pasi 56% e qytetarëve janë shprehur se kanë mundësi t'i përdorin dhe aktualisht i përdorin këto shërbime. Në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, ky tregues ndryshon nga 6% në Bosnje-Hercegovinë, në 40% në Kosovë, 18% në Maqedoninë e Veriut, 17% në Malin e Zi, 25% në Serbi, ndërsa mesatarja për Ballkanin Perëndimor është 27%.

Qeveria shqiptare e ka konsideruar digjitalizimin si proces të rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë dhe lehtësimin e qasjes në shërbime për qytetarët dhe bizneset që veprojnë në vend. Raporti “2021 – Revolucioni digjital në funksion të luftës kundër korrupsionit” paraqet arritjet kryesore të institucioneve të administratës shtetërore në përdorimin e digjitalizimit si mundësi për uljen e formave të ndryshme të korrupsionit. Raporti analizon gjithashtu përdorimin e teknologjisë digjitale në disa prej sektorëve kryesorë që janë posaçërisht të ekspozuar ndaj korrupsionit gjatë vitit 2021 dhe thekson përfitimet e përdorimit të kësaj teknologjie. Më tej, raporti vë në dukje disa prej praktikave më të mira për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale kundër korrupsionit, si dhe atyre të ndërgjegjësimit lidhur me korrupsionin në epokën digjitale.

Një gjë e tillë arrihet përmes eliminimit të pjesshëm ose të plotë të ndikimit të faktorit njerëzor mbi cilësinë, shpejtësinë dhe qasjen në shërbimet publike.

3. Raport Monitorimi Përmbledhës Rajonal i OECD/Sigma mbi Parimet e Administratës Publike, fq. 41, gjendet këtu.



Prokurimi publik Prokurimi

Kujdesi shëndetësor

Arsimi Arsimi Arsimi Arsimi

Kadastra Kadastra

1. DIGJITALIZIMI SI MJET PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN

Pak vite më parë ishin të paktë ata që besonin te Revolucioni Digjital dhe shumë të tjerë, skeptikë. Pavarësisht sfidave dhe vështirësive me të cilat u përball Qeveria Shqiptare, përpjekjet në vitet e fundit u përqendruan në zbatimin dhe garantimin e përdorimit të gjerë të sistemeve elektronike për të lehtësuar përpunimin, transmetimin dhe shkëmbimin e informacionit në sektorin publik. Qëllimi i zbatimit të këtyre mjeteve është: përmirësimi i qeverisjes së mirë; sigurimi i shërbimeve efektive; angazhimi publik më i shpejtë. Zbatimi i mjeteve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit kontribuon në mënyrë të qenësishme në ofrimin e shërbimeve publike cilësore, si dhe rrit besimin tek institucionet qeveritare, duke përmbyshur pritshmëritë e qytetarëve në drejtim të transparencës, integritetit dhe llogaridhënies së institucioneve të administratës publike.

Mjetet kryesore të teknologjisë së informacionit që përdoren nga institucionet e administratës publike përfshijnë: shërbimet e e-qeverisjes; sistemet e ndryshme të informacionit për regjistrime (në shkolla, spitale, etj.); sistemet e monitorimit elektronik; sistemet e e-prokurimit; sistemet informatike financiare.

Në Shqipëri, digjitalizimi i ndërveprimit të drejtpërdrejtë dhe të automatizuar ndërmjet qytetarëve dhe nëpunësve civilë përbën një nga shtyllat kyçe të masave antikorrupsion. Procedurat automatike eliminojnë plotësisht nevojën për kontakt të drejtpërdrejtë midis qytetarëve dhe nëpunësve, si dhe ulin rrisin transparencën në ofrimin e shërbimeve publike.

Gjithashtu, mjetet e qeverisjes digjitale ri-dimensionojnë mënyrën mbi bazën e së cilës regjistrohen, ruhen dhe vihen në dispozicion

të dhënat e gjeneruara nga veprimtaria e institucioneve publike. Menaxhimi i shërbimeve në mënyrë digjitale përmirëson gjurmimin, zbulimin, monitorimin dhe hetimin e parregullsive. Përmes këtij procesi garantohet efikasitet dhe llogaridhënie në ofrimin e shërbimeve publike.

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka dëshmuar një ndryshim të konsiderueshëm në mendësinë e ofrimit të shërbimeve. Përqafimi i digjitalizimit dhe mjeteve digjitale në ndërveprimin me qytetarët dhe biznesin ka rezultuar të jetë mekanizmi i duhur për rritjen e cilësisë dhe uljen e nivelit të korrupsionit në ofrimin e shërbimeve. Portali e-Albania, në cilësinë e Platformës Qeveritare të Ndërveprimit, është kthyer në portën kryesore, përmes së cilës

SISTEMI I DIGJITALIZUAR NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE

REDUKTIM I NDËRVEPRIMIT FIZIK

FRENIMI I DISKREACIONIT TË QEVERISË DHE MUNDËSISË PËR KORRUPSION

çdokush mund të marrë shërbimet elektronike të ofruara nga institucionet publike në Shqipëri nëpërmjet internetit.

Si pasojë e rritjes së ndjeshme në numrin e shërbimeve elektronike të ofruara nga institucionet publike shqiptare përgjatë viteve të fundit, qytetarëve shqiptarë u janë kursyer **766 vite qëndrimi në radhë dhe rreth 6.5 milionë euro**. Falë transformimit digjital, Shqipëria gjithashtu ka kursyer 160 milionë fletë A4, 800 ton letër, 16 mijë pemë, 68 milionë litra ujë dhe 5500 MWh energji elektrike duke ndikuar në mënyrë pozitive edhe në mjedis. Shtimi në shkallë kaq të gjerë i e-shërbimeve që ofrohen ka ulur ndjeshëm burokracinë dhe ka hedhur themelet për ndryshimin e kulturës së komunikimit ndërmjet institucioneve që ofrojnë shërbime nga njëra anë dhe qytetarëve e bizneseve nga ana tjetër.

Periudha e krizës së COVID-19 ka pasur një ndikim thelbësor edhe në forcimin e qëndrueshmërisë së institucioneve publike për t'i bërë ballë pasojave të krizës. Në total, koha e qëndrimit në radhë që e-Albania u ka kursyer qytetarëve gjatë pandemisë vlerësohet të jetë **293 vite dhe 1.36 milionë euro** për të gjithë aplikantët, qytetarët dhe bizneset.

Ndërkohë që teknologjitë inteligjente shfrytëzohen si një mjet efektiv për të rritur transparencën dhe efikasitetin, institucionet shqiptare janë të angazhuara në mënyrë të vazhdueshme për të ndërgjegjësuar përfitimet që sjell përdorimi i tyre. Ka ende shumë sfida në rrugën drejt krijimit të një sistemi digjital që pengon praktikën korruptive në mënyrë të gjithanshme. Me zgjerimin e shërbimeve digjitale, po investohet në zbatimin e masave dhe sistemeve mbrojtëse shumëplanëshe për të parandaluar keqpërdorimin e të dhënave. Në këtë kuadër, janë marrë masa për mbrojtjen e infrastrukturave dhe sistemeve qeveritare, duke filluar nga më të thjeshtat si ato të përqendruara antivirus-i, firewalls, e deri te sistemet e zbulimit dhe përgjigjes (Endpoint Detection & Response), platforma për mbrojtjen e avancuar të trafikut e-mail dhe izolimin e kërcënimeve (ATP), sisteme



HoneyPot, analiza sjelljesh përmes ndërlidhjes së të gjithë informacioneve në një platformë të vetme, kalimi në modelin zero-trust. Gjithashtu, AKSHI, e-Albania dhe Platforma Qeveritare e Ndërveprimit janë certifikuar me standarde ndërkombëtare ISO 27001 dhe 20000-1 për sigurinë e informacionit në të dyja nivelet teknike dhe ISO 9001 për menaxhimin e sistemeve.

Njëkohësisht nëpunësit e administratës publike po aftësohen për të përqaftuar një ndryshim të tillë. Me qëllim rritjen e produktivitetit të këtyre mjeteve

në frenimin e praktikave të korrupsionit do të intensifikohet analiza e të dhënave për gjurmimin e modeleve të sjelljes dhe riskut të integritetit edhe përmes aftësimin të nëpunësve për të përdorur mjete digjitale për funksionimin e brendshëm të administratës publike.

Përpjekjet për të përmirësuar aksesin në shërbimet publike digjitale edhe për grupet vulnerabël, kërkojnë zbatimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse, duke synuar mundësimin e këtij

shërbimi në çdo cep të Shqipërisë për qytetarët pavarësisht gjendjes së tyre sociale ose ekonomike.

Vizioni i ardhshëm i Qeverisë është eliminimi i plotë i kontaktit fizik mes qytetarit dhe administratës, për të parandaluar korrupsionin, për të rritur cilësinë e ofrimit të shërbimeve, për të shmangur radhët e gjata në sportelet e institucioneve si dhe për t'i kursyer kohë dhe para qytetarëve. Kjo do të arrihet përmes ofrimit dhe marrjes së përgjigjes vetëm në mënyrë elektronike

për 95% të shërbimeve publike të shtetit shqiptar si dhe reduktimit të sporteleve fizike të institucioneve. Për të gjitha aplikimet e bëra në platformën e-Albania, dokumenti përfundimtar do t'i jepet qytetarit apo biznesit me vulë ose nënshkrim elektronik. Çdo përgjigje e administratës do të monitorohet përmes një sistemi të qendëruar, për të siguruar respektimin e afateve të kthim-përgjigjeve.

Sportelet e administratës nuk do të ofrojnë më

Numri i databazave të ndërlidhura në vite
(për më shumë informacion www.akshi.gov.al)



2013v

asnjë shërbim që nuk kërkon domosdoshmërisht prezencën fizike të qytetarit apo mjetit.

Do të punohet po ashtu për digjitalizimin e arkivave fizike, për të rritur numrin e dokumenteve që merren në kohë reale me vulë elektronike, duke evituar tërësisht ndërhyrjen njerëzore në përgatitjen e dokumentit përfundimtar. Integrimi i teknologjive të reja në sistemet qeveritare do të mundësojë në vitet në vijim, përmirësimin e ofrimit të cilësisë së shërbimeve dhe automatizimin e mëtejshëm të tyre.

95%
E SHËRBIMEVE PUBLIKE
OFROHEN ONLINE PËR
QYTETARËT DHE BIZNESET

RUAR NË PORTAL

VEPROJNË


55

2 360 000

FORMË

198 000 000

S2021



2. DIGJITALIZIMI PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT NË SEKTORËT KYÇ

2.1 Prokurimi Publik

Prokurimi publik përbën një nga sektorët e ndjeshëm ndaj ndikimeve të mundshme të veprimtarive korruptive, duke pasur parasysh rëndësinë e procesit të prokurimit në menaxhimin e fondeve publike. Rëndësia e këtij sektori theksohet edhe nga Raporti Vjetor i Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) për vitin 2021, i cili tregon se vlera totale e prokurimit publik në vitin 2021 arrin në 8.9% të GDP/PBB-së⁴ (149.3 miliardë lekë).

Për shkak të rëndësisë së këtij sektori dhe ndjeshmërisë së procesit të prokurimit, përdorimi i mjeteve digjitale për zhvillimin e procedurave të prokurimit, ka vlerë të veçantë në analizimin e sjelljes dhe identifikimin e shkeljeve të mundshme si dhe riskut të integritetit në këtë fushë. Aktualisht, zhvillimi i procedurave të prokurimit bazohet në standardet dhe praktikën më të mira të diktuar nga *Acquis* e BE-së, parashikuar në legjislacionin e

prokurimit publik të miratuar në vitin 2020.⁵

Mjeti kryesor i digjitalizimit për zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe parandalimin e shkeljeve dhe korrupsionit të mundshëm në prokurimet publike në Shqipëri është Sistemi i Prokurimit Elektronik (SPE, e-prokurimi). Ky sistem përfshin të gjithë procesin e prokurimit publik që nga krijimi i Regjistrit të Parashikimeve për Procedurat e Prokurimit Publik deri në finalizimin e procesit me fituesin si dhe krijimin e Regjistrit të Realizimit të Procedurave të Prokurimit Publik. SPE është një sistem qendror, përdorimi i të cilit është i detyrueshëm në zhvillimin e procedurave të prokurimit nga të gjitha autoritetet apo entet kontraktore që prej vitit 2009. Përmes tij regjistrohen të gjitha veprimet dhe gjenerohen në mënyrë automatike analizat e sistemit. Me anë të tij bëhet i aksesueshëm çdo informacion në lidhje me procedurat e prokurimit, përfshirë dokumentet e tenderit, nga çdo palë e interesuar pa pagesë dhe në çdo kohë, duke mundë-

4. Raporti Vjetor 2021 i Agjencisë së Prokurimit Publik, fq. 11., raporti gjendet ketu.

5. Ligj 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe aktet nënligjore dala në zbatim të tij



PROKURIMI PUBLIK NUMRI I PROCEDURAVE ME NEG

SEKTORI FINANCIAR 52.5% E KOMPA

99% E TË GJITHA SHËRBIMEVE TATIMORE O

34 NGA 41 SHËRBIME DOGANORE OFRO

KUJDESI SHËNDETËSOR CERTIFIKATA E VAKSINIM

MBI 2.2 MILIONË APLIKIME PËR SHËRBIME SHËNDETËS



GJET
KRYE

TRANSPORTI RINOVIMI I LEJES SË DREJTIMIT U KA KURS

+1.5 MILIONË SHËRBIME TË OFRUARA NGA DREJTORIA E F

ARSIMI RRRITJE ME 39% E NUMRIT TË MËSUES

RRITJE ME 166.88% E CERTIFIKATAVE T

KOHA E PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE U UL MESAT

OCIM PA SHPALLJE PARAPRAKE KA RËNË NËN 3.4%

PANIVE AKTIVE JANË FISKALIZUAR

DIFROHEN NËPËRMJET PORTALIT E-ALBANIA

DHEN NËPËRMJET PORTALIT E-ALBANIA

MIT COVID-19 ËSHTË LËSHUAR QË NGA JANARI 2021

SORE JANË DORËZUAR, DUKE KURSYER 63 VITE KOHË

TJET
SORE

YER QYTETARËVE: 1,161,211 KM RRUGË, 15,444,107 LEKË

PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

VE TË PUNËSUAR PËRMES PORTALIT ONLINE

Ë PRONËSISË TË LËSHUARA NGA ASHK

TARISHT NGA 101 DITË (2017) NË 23.3 DITË (2021)



suar transparencë maksimale, gjurmueshmëri të procedurave të prokurimit dhe reduktim të mundësive për abuzim.

Nga ana tjetër, si një hap me tej drejt transparencës, gjatë vitit 2021 në faqen e internetit të APP është mundësuar aksesimi i të dhënave të mësipërme edhe në format Excel (Open Data) për periudhën 2010-2021, gjë që bën më të lehtë përpunimin e tyre nga të gjithë personat e interesuar⁶.

Përdorimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik është i detyrueshëm në të gjitha procedurat e prokurimit, pavarësisht vlerës së tyre, përfshirë ato me vlerë të vogël, si edhe procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

Përdorimi i mjeteve digjitale në procedurat e prokurimit, si dhe angazhimi i APP-së për të përmirësuar sistemin e prokurimit publik në Shqipëri, ka sjellë rezultate konkrete në rritjen e transparencës dhe reduktimit drastik të numrit të procedurave të prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. Ulja e numrit të procedurave të tilla, të cilat për nga natyra e tyre, mund të krijojnë mungesë transparence kanë ulur ndjeshëm mundësinë e abuzimeve dhe pengesave lidhur me konkurrencën në procesin e prokurimit⁷.

Në këtë kuptim, vitet e fundit kanë shënuar një zhvillim pozitiv në uljen e numrit të procedurave të mësipërme. Rënia më e konsiderueshme është shënuar në vitin 2018, kur nga 31.81% që ishte përqindja e tyre në raport me numrin total të

procedurave të përfunduara me fitues në vitin 2017, u ul në 9.4%.

Ulja drastike e numrit të procedurave me negociim pa njoftim paraprak, brenda një viti lidhet me detyrimin për herë të parë, në fund të vitit 2017, të autoriteteve kontraktore për ta zhvilluar këtë lloj procedure nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, duke mundësuar monitorimin dhe gjurmimin e tyre në kohë reale⁸.

Ndërkohë, në vitin 2021 është shënuar numri më i ulët i kësaj lloj procedure, që nga viti 2010⁹.

APP është angazhuar maksimalisht në asistimin e autoriteteve kontraktore gjatë procesit të hartimit të dokumenteve të tenderit, me qëllim shmangien e përdorimit të kriterëve dhe specifikimeve teknike abuzive apo që mund të përbëjnë shkak për favorizime të mundshme të operatorëve ekonomikë të caktuar. Konkretisht, gjatë vitit 2021, APP ka asistuar autoritetet kontraktore duke dhënë rekomandimet përkatëse për 3,069 procedura prokurimi të publikuara (60.4% të numrit total të procedurave të publikuara)¹⁰ dhe duke nxjerrë rekomandime të herëpashërshme për të gjitha Autoritetet Kontraktore.

Me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë së Autoriteteve Kontraktore në hartimin e kriterëve gjithëpërfshirëse që nxisin konkurrencën në procedurat e prokurimit, për herë të parë gjatë vitit 2021, u parashikua detyrimi i AK-ve të publikojnë në sistemin e prokurimit elektronik, së bashku me Dokumentet e Tenderit dhe procesverbalin e argumentimit të kriterëve dhe kërkesave për

6. Për sa më sipër <https://www.app.gov.al/eksportimi-i-procedurave-te-publikuara/>

7. Duke parë përvojat e shkuara të Shqipërisë me prokurimin elektronik, janë të dukshme përfitimet e monitorimit dhe gjurmimit të veprimtarisë së AK-ve në fazat e hershme të procedurës së prokurimit. Hapi i parë i APP-së ishte të ndërmerre disa zhvillime në SPE, për të krijuar dhe "përkthyer" procesin ligjor të punës në proces teknik për kryerjen e procedurës së negociuar pa shpallje paraprake, "Innovation as a monitoring tool to strengthen law enforcement - an Albanian public procurement case"


8. Shiko Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 796, datë 29.12.2017.

9. Shiko Raporti Vjetor 2021 i Agjencisë së Prokurimit Publik

10. Shiko Raporti Vjetor 2021 i Agjencisë së Prokurimit Publik

Trendi i procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës nga totali i procedurave të shpallura

E-PROKURIMI



kualifikim, për çdo procedurë prokurimi që zhvillojnë.

Përdorimi i këtij sistemi të digjitalizuar si një mekanizëm monitorues e parandalues ka rezultuar efektiv në pasqyrimin e të dhënave të qarta të shpenzimeve publike me procedurat e prokurimit që përfshijnë emergjencat e shkaktuara nga pandemia dhe tërmeti. Gjatë vitit 2021, pati një reduktim të ndjeshëm të numrit të procedurave të përgjithshme të prokurimit të shpallura në krahasim me vitin 2020. Kjo tendencë ka ardhur si pasojë e uljes së numrit të procedurave të prokurimit të përqendruara në adresimin e pasojave të situatave të emergjencës. Për pasojë, është ulur edhe shuma totale e fondit të prokurimit të shpallur gjatë vitit 2021, krahasuar me atë të vitit 2020. Nga **63.4 miliardë lekë** që ishte fondi i prokurimit i shpallur në vitin 2020, ky fond u ul në **17 miliardë lekë në vitin 2021**. Përsa i përket shpenzimeve për COVID-19, në vitin 2021 **“Procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”** për shkak të pandemisë së shkaktuar nga COVID-19 zënë vetëm **0.7% të fondit total** të shpenzuar për procedurat me negociim pa shpallje paraprake¹¹, ndërsa shuma më e madhe

MENAXHIMI I KONTRATËS SË PROKURIMIT PUBLIK

E-kontrata


E-fatura

E-raporte

Vërtetime për realizimin e suksesshëm të kontratës

11. Raporti Vjetor 2021 i Agjencisë së Prokurimit Publik, fq. 49., dhe Raporti Vjetor 2020 i Agjencisë së Prokurimit Publik, fq. 53, raportet gjenden këtu


Trendi i procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës nga totali i procedurave të shpallura



shkon për prokurimin për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe lloje të tjera kontratash.

Përpos digjitalizimit të procesit të konkurrimit elektronik, u mundësua edhe ngritja e sistemit të menaxhimit të kontratave publike, i cili synon garantimin e ndërlidhjes midis institucioneve

si Agjencia e Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Qendra Kombëtare e Biznesit. Përmes këtij sistemi, menjëherë pas njoftimit të fituesit në APP, nis procesi i zbatimit të kontratës mes autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik fitues, i cili është plotësisht



elektronik.

Me anë të këtyre përditësimeve, operatori ekonomik pajiset me kontratë elektronike, me nënshkrim elektronik. Ndjekësit e kontratës do të deklarohen në sistem. Faturat elektronike, raportet dhe vërtetimet për realizimin e suksesshëm të kontratës do të ngarkohen në sistem me nënshkrim elektronik.

Përmes digjitalizimit të këtij procesi, gjurmohet lehtësisht koha e dorëzimit të faturave apo raporteve nga operatorët ekonomikë dhe miratimi i tyre nga nëpunësit përgjegjës në administratën publike. Në këtë mënyrë, synohet një mekanizëm efektiv që parandalon mundësinë e abuzimit nga funksionarët publikë.

2.2 Sektori Financiar

Gjatë vitit 2021, sektori financiar ka dëshmuar progres të konsiderueshëm në digjitalizimin dhe në disponueshmërinë e shërbimeve financiare on-line duke prezantuar e zbatuar mekanizma të reja për të parandaluar informalitetin, korrupsionin dhe flukset e paligjshme financiare, si dhe për të rritur qëndrueshmërinë e përgjithshme të sektorit përballë pandemisë së COVID-19 dhe faktorëve të tjerë që kontribuojnë në stabilitetin makro-ekonomik të vendit.

E-shërbimet tatimore

Digjitalizimi në sektorin e tatimeve ka garantuar suksesin e menaxhimit të shërbimeve duke eliminuar plotësisht nevojën për dorëzimin e formularëve me kërkesat në zyrën e informacionit dhe nevojën për të ndërvepruar personalisht me autoritetet tatimore. Prej vitit 2015-të, administrata tatimore ka pësuar një transformim në informatizimin e sistemeve të saj, duke filluar me zbatimin e sistemit të ri të teknologjisë informatike C@TS. Ky sistem solli një revolucion në regjistrimin

15 SHËRBIME ONLINE - QË PËRBËJNË DERI NË 99% TË TË GJITHA SHËRBIMEVE TË OFRUARA NGA ORGANET TATIMORE

15
2021

12
2020

11
2019


ZBATIMI I SISTEMIT TË TEKNOLOGJISË INFORMATIKE

DORËZIMI ONLINE I DEKLARATAVE TATIMORE


VETËKORRIGJIMI I DEKLARATAVE FISKALE

ELIMINIMI I KONTAKTIT FIZIK INSPEKTOR TATIMOR - TATIMPAGUES

VËRTETIME TË MARRA NË ZYRË vs VËRTETIME TË MARRA NGA e-ALBANIA



tatimor për subjektet tatimpaguese. Ai u mundëson atyre një sistem që i lejon të kontrollojnë deklarimet fiskale, të modifikojnë dhe korrigojnë, të depozitojnë dokumentet tatimore në rrugë elektronike, si dhe të dorëzojnë të gjitha deklaratat tatimore përfshirë edhe pasqyrat financiare vjetore on-line. Një transformim i tillë është nxitur edhe nga zbatimi i shërbimeve të portalit qeveritar *e-Albania* në tetor 2017-të, i cili ofronte fillimisht vetëm 9 shërbime on-line. Shërbimet e përdorura në këtë periudhë kishin të bënin me kërkesat më të shpeshta, për vërtetime nga tatimpaguesit dhe qytetarët.



Ato kryesisht lidheshin me: certifikim të deklarimit të pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për tatimpaguesit dhe qytetarët; certifikim të xhirove të bizneseve në tre vitet e fundit; historikun e punësimit të individëve; certifikimin e statuseve në regjistrat e Administratës Tatimore.

Në vitin 2019 u shtuan edhe dy shërbime të tjera: e-Konfirmimi i listëpagesës dhe e-Certifikatë rezidence për subjektet. Në vitin 2020 u shtuan 4 shërbime për proceset e regjistrimit të kategorive të individëve, si fermerë, ambulantë, përfaqësues tatimorë dhe kryefamiljarë pranë Administratës Tatimore, si dhe Certifikatën e Rezidencës për individët.

Në vitin 2021 numri i shërbimeve të ofruara nga e-Albania ishte 15 dhe shërbimet e ofruara on-line përbënin deri në 99% të totalit të tyre, duke i lënë shumë pak vend kontaktit personal përmes zyrës së informacionit dhe duke shmangur mundësinë e përfshirjes së punonjësve të sistemit tatimor në praktikatat të abuzimit dhe korrupsionit.

Në figurën e mëposhtme pasqyrohet një vështrim krahasues i shërbimeve të ofruara në sportele me ato të ofruara nëpërmjet Platformës e-Albania për periudhën 2016 – 2021. Siç tregojnë shifrat është rritur niveli i marrjes së shërbimeve nëpërmjet Platformës e-Albania dhe reduktuar në mënyrë drastike ofrimi i tyre përmes sporteleve. Në vitin 2021 numri i këtyre shërbimeve është pothuajse dyfishuar në krahasim me vitin e parë të ofrimit të tyre në 2018. Ndërkaq është ulur me më shumë se dy herë numri i shërbimeve në sportele gjatë vitit 2021, krahasuar me vitin 2018 dhe 93% në krahasim me vitin 2017.

Këto shifra vërtetojnë faktin se digjitalizimi i shërbimeve në ndihmë të qytetarëve dhe bizneseve ka përshpejtuar dhe thjeshtuar aksesin dhe marrjen e shërbimeve tatimore. Platformat digjitale të institucioneve janë përthithur me sukses në platformën e-Albania. Falë përdorimit të platformave digjitale gjatë vitit 2021, për herë të parë administrata jonë tatimore shkëmbeu informacion mbi llogaritë financiare me më shumë se 80 administrata të tjera tatimore.

Fiskalizimi

Fiskalizimi është reforma më e thellë në sistemin e faturimit dhe monitorimit. Sistemi i ri i faturimit¹² synon digjitalizimin e faturimit dhe monitorimit, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Sistemi ka hyrë në fuqi që prej fundit të vitit 2019, me miratimin e legjislacionit dhe akteve nënligjore, si dhe me krijimin e infrastrukturës së nevojshme mbështetëse. Më 1 janar 2021, nisi faza e parë e zbatimit të kësaj reforme, e cila ka në qendër transaksionet pa para në dorë midis tatimpaguesve (biznes) dhe Enteve Publike (B2G), duke lëshuar fatura të fiskalizuara.

Në 1 korrik 2021 nisi faza e dytë për transaksionet pa para në dorë midis tatimpaguesve biznes me biznes (B2B), ndërsa më 1 shtator 2021,

faza e fundit për transaksionet mes tatimpaguesve apo bizneseve dhe konsumatorit (B2C).

Sistemi synon veçanërisht të identifikojë abuzuesit potencialë dhe të shmangë inspektimet e mundshme nga organet tatimore që mund të pengojnë funksionimin e rregullt të çdo biznesi.

Fiskalizimi mundëson kontrolle mbështetur vetëm në riskun e mundshëm dhe shmang kontaktin e administratës tatimore me tatimpaguesin duke eliminuar kontrollet rastësore apo përsëritëse, teksa fokusi vendoset tek tatimpaguesit, të cilët i shmangen deklarimit. Nëpërmjet këtij sistemi dhe të sistemeve të tjera që përdoren nga administrata tatimore synohet kontrolli në distancë nëpërmjet evidentimit, krahasimit dhe analizimit të të dhënave nga shumë burime.

KOMPANI PRIVATE AKTIVE TË PAJISURA ME CERTIFIKATË FISKALIZIMI



MILION FATURA
FISKALE TË
LËSHUARA

12. Parashikuar me ligjin Nr. 87/2019 "Për faturat dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit"





Regjistri digjital i pronarit përfitues dhe llogarisë bankare

Transparenca mbi pronarët përfitues dhe llogaritë bankare konsiderohet si mjet kyç në luftën kundër evazionit fiskal, korrupsionit dhe flukseve të paligjshme financiare, me theks të veçantë te pastrimi i parave. Me krijimin dhe konsolidimin e këtyre regjistrave digjitalë përgjatë vitit 2021, u vendos një bazë solide për të shmangur anonimin në pronësi, për të siguruar prova për pasuri të pashpjegueshme, si dhe për të ofruar terren për verifikim pranë organeve

ligjzbatuese. Regjistri i llogarive bankare menaxhohet nga administrata tatimore, ndërsa regjistri i pronarëve përfitues administrohet nga QKB, të dy këta regjistra të ngritur nga AKSHI.

Deri më datë 25.03.2022, janë 41,859 subjekte raportuese që kanë regjistruar të dhënat për pronarët e tyre përfitues në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, nga të cilët 2,082 subjekte raportuese janë OJF dhe 39,777 janë subjekte tregtare të regjistruara në regjistrin tregtar.

49.6% E SUBJEKTEVE
TË BIZNESIT KANË HEDHUR
TË DHËNAT E TYRE NË
REGJISTRIN E PRONARËVE
PËRFITUES.

90.88% E ORGANIZATAVE
JO-FITIMPRURËSE AKTIVE
KANË HEDHUR TË DHËNAT
E TYRE NË REGJISTRIN E
PRONARËVE PËRFITUES.

MBI 3 MILIONË LLOGARI
BANKARE JANË REGJISTRUAR
NË REGJISTRIN QENDROR TË
LLOGARIVE BANKARE.

Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të Ligjit Nr. 112/2020, “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”, i ndryshuar, synohet përmirësimi i mëtejshëm dhe lehtësimi i procesit të regjistrimit të pronarëve përfitues. Kjo bëhet më qëllim që të garantohet se subjektet raportuese, që kanë detyrimin ligjor të regjistrojnë të dhënat e pronarëve përfitues, ta përmbushin këtë detyrim brenda afateve të përcaktuara nga ligji.

Gjithashtu, vijon puna për zbatimin rigoroz të parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fushën e regjistrimit të pronarëve përfitues dhe për ofrimin e asistencës për biznesin në këtë regjistër.

2.3 Kujdesi shëndetësor

Spektori i shëndetësisë është shumë i brishtë ndaj praktikave të mundshme korruptive. Vëmendja ndaj abuzimeve potenciale në këtë sektor është shumëfishuar veçanërisht në kohë krizash, siç është ajo e shkaktuar nga pandemia e COVID-19. Pavarësisht të panjohurave të pandemisë, u morën një sërë masash që prej fillimit, të cilat ndikuan në mënyrë thelbësore në përbalimin dhe ecurinë e mëtejshme të pandemisë. Krahas vendimmarrjes së shpejtë që në fillim të krizës dhe planifikimit të kujdesëshëm të strukturave shëndetësore (përfshirë ato spitalore) të dedikuara për menaxhimin e pandemisë, zbatimi i suksesshëm i shëndetësisë elektronike luajti një rol kyç, duke fuqizuar dhe qendëruar rolin e mjekut të familjes, proces ky i nisur që përpara pandemisë.

Megjithë presionin e madh që ka shkaktuar pandemia në sistemin shëndetësor, ajo ka përshpejtuar ndjeshëm digjitalizimin në këtë sektor. Mjetet digjitale janë shpeshherë përcaktuese në frenimin e korrupsionit, në aspekte të ndryshme të ndërveprimit midis qytetarëve dhe autoriteteve shëndetësore, dhe shërbejnë si mekanizëm i qenësishëm për të siguruar llogaridhënie më të lartë.

Viti 2021 shënoi përparim të konsiderueshëm në sistemin e kujdesit shëndetësor, ndërkohë që po përballej me presionin gjithnjë në rritje të

+2.2

MILIONË APLIKIME PËR SHËRBIME SHËNDETËSORE JANË DORËZUAR NGA QYTETARËT NË RRUGË ELEKTRONIKE DUKE KURSYER RRETH 63 VITE KOHË.



+150,000

REFERIME ELEKTRONIKE ON-LINE NË MUAJ GJATË VITIT 2021 U OFRUAN PËR SHËRBIME SHËNDETËSORE DHE EKZAMINIME TË SPECIALIZUARA SHËNDETËSORE.

shkaktuar nga pandemia COVID-19. Së bashku me zbatimin e metodave të telemjekësisë (vizitave on-line), institucionet shëndetësore menaxhuan përmes shërbimeve ekzistuese në portalin e-Albania krizën e COVID-19, duke garantuar ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe rimbursimin e recetave mjekësore për pacientët me COVID-19.

Sigurimi digjital i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Mbrojtjes Sociale garanton:

- **Monitorimin në kohë reale të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve;**
- **Sigurimin e cilësisë në ofrimin e shërbimit;**
- **Përmirësimin e aksesit në Shërbimet Shëndetësore dhe të Mbrojtjes Sociale;**
- **Krijimin e një bazë të dhënash elektronike në përpunimin e informacionit të nevojshëm për vendimmarrje.**

Pesë shërbime kyçe u ofrohen qytetarëve përmes portalit qeveritar *e-Albania*:

- **Kontakt / Regjistrimi pranë Mjekut të Familjes** (Dhjetor 2020);
- **Kartë Shëndeti me vullë elektronike** (Shkurt 2016);
- **Skedulimi dhe Riskedulimi** i datës së marrjes së shërbimit të specializuar mjekësor, nëpërmjet sistemit të referimit elektronik (Janar 2020);
- **Certifikatë Vaksinimi COVID-19**, si pjesë integrale e sistemit të certifikatave të vaksinimit të BE-së, e pajisur me një kod QR dhe nënshkrim elektronik (Janar 2021);
- **Certifikatë Rikuperimi nga COVID-19** (Dhjetor 2021).

Gjatë vitit 2021, janë dhënë mbi 3,9 milionë receta elektronike për mbi 410,000 pacientë, për sëmundje kronike dhe akute, të lëshuara nga 1,500 mjekë në të gjithë vendin, duke lehtësuar procesin në tërësi dhe duke rritur transparencën.

Këto receta nënshkruhen në mënyrë elektronike nga mjekët dhe farmacistët, një procedurë që i nënshtrohet raportimit, mbikëqyrjes dhe transparencës on-line, duke garantuar ndjekjen e protokolleve të trajtimit dhe duke ulur mundësinë për abuzim. Farmacisti ekzekuton recetën vetëm pasi merr vërtetimin e kodit të gjeneruar nga sistemi, gjatë vizitës nga mjeku i familjes. Sipas INSTAT në Tiranë, ku jeton pjesa më e madhe e popullsisë së vendit, 33% dhe ku ushtron detyrën një e pesta e trupës profesionale e mjekëve të familjes, lëshohen rreth 27% e recetave elektronike.

Sipas këtij sistemi, caktohen konsulta dhe ekzaminime të specializuara mjekësore on-line nga mjekët e përgjithshëm, duke rritur transparencën dhe ulur mundësinë për korrupsion. Implementimi i sistemit elektronik të referimit ka reduktuar gjithashtu, në mënyrë drastike kohën e pritjes. Aktualisht, një pacient që ka nevojë të kryejë një ekzaminim CT (skaner), falë referimit elektronik e merr shërbimin brenda disa ditëve, në kontrast me pritjen prej të paktën 2 muajsh që ekzistonte në periudhën e referimit manual në sportel.

E-vizitat - sistemi që regjistron në mënyrë elektronike vizitat dhe shërbimet shëndetësore, duke krijuar bazën për Kartë Shëndeti me vullë elektronike.

PEŠË SHËRBIME KYÇE U OFROHEN QYTETARËVE PËRMES PORTALIT QEVERITAR E-ALBANIA:

1 KONTAKTI /
REGJISTRIMI
PRANË MJEKUT
TË FAMILJES

2 KARTË
SHËNDETI
ME VULË
ELEKTRONIKE

3 SKEDULIMI
DHE
RISKEDULIMI

4 CERTIFIKATË
VAKSINIMI
COVID-19

5 CERTIFIKATË
RIKUPERIMI
NGA
COVID-19

Ky sistem mundëson ruajtjen e historikut të diagnozave e të dhënave shëndetësore të pacientit dhe për analiza të thelluara mjekësore. Gjatë vitit 2019 është rritur efica e kohës së profesionistëve të kujdesit shëndetësor, përmes 4 sistemeve (receta, referime, regjistër i pacientit, e-Vizita) të teknologjisë Single Sign On (akses i unifikuar i mjekut në të katër sistemet). Duke pasur informacion të detajuar dhe të plotë lehtësohet mbikëqyrja e performancës dhe vendimmarrjes së mjekut, me qëllim reduktimin e abuzimit ose korrupsionit të mundshëm.

Regjistri Elektronik i pacientëve (*e-Register*), i vënë në përdorim gjatë vitit 2016, nëpërmjet dokumentit me vulë elektronike (Karta e Shëndetit), vërteton kategorinë e përfitimit të Sigurimit Shëndetësor të pacientit, duke eliminuar nevojën për dokumentacione shoqëruese. Shërbimi është i aksesueshëm nga qytetari dhe Institucionet e Kujdesit Shëndetësor përmes portalit *e-Albania*.

Pavarësisht progresit të dukshëm në digjitalizimin e shërbimeve në sistemin shëndetësor, ende mbeten sfida për reduktimin e shkeljeve të mundshme dhe korrupsionit. Në vijim, do të rritet shtrirja e përdorimit të shërbimeve digjitale në zona të largëta, autonomia e institucioneve të kujdesit shëndetësor dhe llogaridhënia lidhur me performancën e përmbushjen e detyrave të tyre. Zgjerimi i përdorimit të shërbimeve on-line shërben në funksion të zvogëlimit maksimal të hapësirave për shkelje dhe korrupsion, ndërsa rritja e autonomisë së institucioneve të kujdesit shëndetësor, rrit në mënyrë të drejtpërdrejtë llogaridhënien, efica e cilësinë e shërbimeve.

2.4 Arsimi

Arsimi është një tjetër sektor me risk të lartë korrupsionit dhe abuzimi me pushtetin, i cili ka një efekt të dëmshëm e të drejtpërdrejtë në zhvillimin e brezave të rinj. Gjatë viteve 2020 dhe 2021, pandemia ka ushtruar presion të konsiderueshëm mbi funksionimin e sistemit arsimor. Për t'iu përshatur rrethanave të reja, është zbatuar modeli i procesit mësimor në distancë. Një proces i tillë është shoqëruar pashmangshmërisht me vështirësi në sigurimin e aksesit në arsim, duke theksuar edhe një herë nevojën për intensifikimin e përdorimit të mjeteve digjitale në këtë sistem.

Në sistemin parauniversitar, një sërë mjetesh digjital përmirësimuan komunikimin me nxënësit dhe studentët dhe siguruan llogaridhënie më të madhe të studentëve dhe mësuesve. Shërbimet on-line në fushën e arsimit janë në rritje.

Sistemi i Menaxhimit të Informacionit

Parauniversitar mundësoi me regjistrin elektronik të notave, mungesave dhe aktivizimit të nxënësve në klasë rivendosjen në një platformë digjitale të komunikimit midis trinomit “mësues-prind-nxënës”. Sistemi krijon **regjistrin digjital**, atë elektronik të notave, të mungesave dhe të aktivizimit të nxënësve në klasë, ndërsa prindërit njihen me ecurinë e fëmijëve nëpërmjet një aplikacioni në celular. Ky aplikacion është në fazë zbatimi e deri në fund të vitit 2021 është mbushur me 479,115 të dhëna individuale që u takojnë kategorive: punonjës (34,225); administratorë (6,094); nxënës



e- ALBANIA KA
KURSYER 52 VITE KOHË
PRITJE PËR **930,000**
PROCESE APLIKIMESH
TË MENAXHUARA NË
RRUGË DIGJITALE PËR
FONDIN E EKSELENCËS,
MATURËN SHTETËRORE
DHE REGJISTRIMIN
NË SHKOLLAT
PROFESIONALE.

PARANDALOHEN
KORRUPSIONI DHE
ABUZIMI I MUNDSHËM,
PASI SISTEMI
ELEKTRONIK PËRCAKTON
SHKOLLËN QË MBULON
VENDBANIMIN SI DHE
TRANSFERIMIN E
NXËNËSVE.

INFORMIMI NË KOHË
REALE I PRINDËRVE PËR
NOTAT, MUNGESAT DHE
ECURINË E FËMIJËVE
PËRMES NJË APLIKACIONI
TË DEDIKUAR NË
CELLULAR

(358,776); mësues (31,394); klasa të krijuara (20,635); klasa me kurrikul të zbatuar (17,061); klasa me regjistër të hapur (10,930).

Për herë të parë në vitin 2021, përmes e-Albania u ofrua sistemi i ri i regjistrimit të nxënësve të klasave të para në shkollat e qyteteve kryesore të qarqeve dhe klasave të dhjeta në të gjithë vendin. Prindërit dhe kujdestarët ligjorë aplikuan drejtpërdrejt në portal, pa pasur nevojë të paraqiteshin në sportele të ndryshme. Përmes këtij sistemi, ata ishin në gjendje të gjurmonin online aplikimin e tyre dhe vendimin përfundimtar të pranimit ose refuzimit. Për arsimin fillor ka pasur gjithsej 10,569 aplikime, nga të cilat janë pranuar dhe regjistruar 8,183 nxënës në 183 shkolla dhe janë refuzuar 2,386 aplikime, ndërsa për arsimin e mesëm të lartë ka pasur 13,366 aplikime, nga të cilat janë pranuar dhe regjistruar 12,088 nxënës në 255 shkolla dhe refuzuar 1,278 aplikime.

Përveç sistemit të digjitalizuar parauniversitar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka ngritur **Sistemin e Provimeve të Shtetit për Profesionet e Rregulluara**, i cili është gjithashtu i aksesueshëm përmes e-Albania. Ky sistem siguron automatizimin e plotë të procedurës së kontrollit, shpërndarjen e kandidatëve në ambientet përkatëse të testimit, si dhe zhvillimin e provimit sipas kushteve specifike. Sistemi gjeneron tezën, mundëson verifikimin e rezultateve të provimit on-line, ndërsa historiku on-line i rezultateve të kandidatit garanton transparencë të plotë në proces. Kështu rritet besueshmëria, shkurtohet koha e qasjes së informacionit dhe mundësohet garantimi i integritetit të procedurës së testimit duke shmangur çdo keqmenaxhim të këtyre procedurave. Duke u ndërlidhur me sisteme të tjera, ai mundëson konfirmimin e pagesës on-line, që kandidati bën para testimit. Rezultatet e provimit printohen automatikisht nga sistemi, duke shmangur gabimet manuale. Institucionet përgjegjëse mund t'i shkarkojnë rezultatet on-line direkt nga sistemi.

PORTALI "MËSUES PËR SHQIPËRINË"
TË PUNËSUAR 2014-2021

1113

2014

1421

2015

1186

2016

654

2017

1730

2018

1997

2019

2748

2020

3819

2021



Portali “Mësues për Shqipërinë” është një platformë digjitale punësimi, ku kandidatët për mësues në arsimin parauniversitar regjistrohen për të marrë pjesë në konkursin për vendin e lirë të punës. Procesi i punësimit realizohet përmes një platforme, që përfshin shpalljen e vendeve të lira të punës, renditjen e kandidatëve në bazë të meritës, konkurrimin dhe shpalljen e rezultateve të konkursit.

Portali “Mësues për Shqipërinë” ka nisur në vitin 2015 dhe ka reduktuar komunikimin e drejtpërdrejtë me përfaqësues të zyrave dhe drejtorive arsimore. Ky portal vlerëson meritokracinë. Renditja e aplikantëve mbështetet në dy faktorë vlerësues që marrin në konsideratë përvojën, kualifikimet, arsimimin. Njëkohësisht aplikantët vlerësohen edhe për performancën e tyre në testimin e njohurive profesionale në fushat respektive.

Udhëzimet që i referohen proceseve kanë rritur transparencën, sepse informacioni publikohet në kohë reale në lidhje me rezultatet e testeve dhe vendet vakante.

Përfaqësuesit e drejtorive arsimore ruajnë renditjen e aplikantëve dhe i gjithë procesi është i publikuar në faqet zyrtare të këtyre drejtorive.

Viti 2021 shënoi një rritje domethënëse me 39% të numrit të mësuesve të punësuar përmes sistemit, krahasuar me 2020.

Pavarësisht vështirësive me të cilat përballlet procesi i digjitalizimit në sistemin arsimor, përgjatë vitit 2021 dëshmohet se janë jetësuar iniciativa që rrisin në mënyrë graduale numrin e mekanizmave të kontrollit dhe llogaridhënies. Këto shërbejnë për të shmangur gjithnjë e më shumë format e ndryshme të abuzimit në këtë sektor, si dhe për të krijuar modele pozitive integriteti në proceset e pranimit të nxënësve, menaxhimit të procesit të tyre të edukimit dhe rekrutimit në sistemin arsimor. Për të përballuar efektet e pandemisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit në vitin 2021 punësoi 1000 mësues përmes portalit “Mësues për Shqipërinë”.

Arsimi gjatë pandemisë

Situata e krijuar nga pandemia COVID-19 detyroi Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) të mbaj të mbyllura të gjitha institucionet arsimore, për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të virusit dhe për të mbrojtur shëndetin e qytetarëve. Në mënyrë që procesi edukativ të vijonte normalisht, i gjithë procesi kaloi te mësimi në kushte shtëpie. U ndoqën dy forma kryesore të mësimdhënies: leksione të filmuara dhe të transmetuara në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH) dhe puna mes nxënësve dhe mësuesve përmes rrjeteve sociale apo platformave të ndryshme që mundësoan krijimin e klasave virtuale (Google classroom, Google hangout, Edmodo, Zoom etj.).

Mësimet e transmetuara në programin televiziv “RTSH Shkolla” u ndoqën nga pjesa më e madhe e nxënësve, prindërve dhe mësuesve. Nxënësit që nuk arritën t’i shohin transmetimet, i ndoqën ato në kanalin Youtube të MAS-së ose në platformën akademi.al. Ngritja e platformës falas të mësimi on-line u shoqërua edhe me shpërndarjen e tabletave për fëmijët e familjeve me ndihmë ekonomike dhe tek ata, shkolla e të cilëve ishte dëmtuar nga tërmeti. Në total janë shpërndarë 15,931 mijë tableta.

Mësimi on-line në kushtet e shtëpisë i bëri mësuesit të ndjekin më shumë platforma trajnimi on-line, duke zhvilluar kapacitetet e tyre profesionale në këtë fushë. Trajnimi i mësuesve për zhvillimin e kompetencave digjitale nga njëra anë ka qenë një nga fushat më prioritare për mësimdhënie bashkëkohore, por nga ana tjetër është pjesa më e vështirë për mësuesit. ASCAP, në bashkëpunim me kompaninë “TeachPitch”, ka kryer trajnime on-line falas për mësuesit, lidhur me përdorimin e platformave on-line për zhvillimin e mësimi në kushtet e shtëpisë. Trajnimi filloi në mars 2020 dhe u trajnuan rreth 10 mijë mësues¹³.


13. Sondazhi i mësimi online

Në fund të muajit maj të vitit 2021, në të gjitha institucionet arsimore u kryen teste për të matur njohuritë e nxënësve dhe mangësitë e tyre. Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) hartoi disa teste për matjen e nxënies gjatë periudhës së pandemisë nga klasa e parë deri në klasën e 12-të.

Mbi bazën e rezultateve u hartuan plane

mësimore për çdo lëndë, të cilat u bënë të zbatueshme në çdo shkollë nën kujdesin e Drejtorive Arsimore Rajonale. Në institucionet arsimore, në shtator 2021, u zhvillua mësim plotësues për lëndët në të cilët nxënësit kishin mangësi. QSHA orientoi trajnimet në të gjitha lëndët, me fokus lëndët e provimeve kombëtare.

PËRDORIMI I PLATFORMAVE ELEKTRONIKE NGA NXËNËSIT





2.5 Pronësia

Adresimi i çështjeve që lidhen me sektorin e pronave mbetet një nga sfidat kyçe në Shqipëri. Ndërkohë që forcimi i sigurisë mbi pronësinë e tokës ka qenë gjithmonë ndër prioritetet më të larta, problematikat e pronësisë ende vuajnë pasojat e dëmeve historike.

Aktualisht, shumica e shërbimeve publike në fushën e pronës dhe të drejtave të tokës ofrohen përmes ASHK-së (Agjencia Shtetërore e Kadastrës).

NUMRI I
PËRGJITHSHËM
I SHËRBIMEVE
KADASTRALE
TË OFRUARA
NË VITIN 2021
U RRIT NË 1.5
MILION NGA 883
MIJË NË VITIN
2020

Më shumë

Më sigurt

Më shpejt

KOHA E
PËRPUNIMIT TË
TË DHËNAVE U
UL ME KATËR
HERË NGA NJË
MESATARE PREJ
101 DITËSH NË
2017 NË 23.3
DITË NË 2021

Në këtë sektor, digjitalizimi i shërbimeve ka nisur në vitin 2020. Aplikimet për shërbime publike bëhen vetëm on-line përmes portalit e-Albania. Gjithashtu, të gjitha dokumentet administrative që shërbejnë si dokumentacion shoqërues për marrjen e shërbimeve elektronike në portalin e-Albania, dorëzohen dhe shkëmbehen vetëm elektronikisht nëpërmjet Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve.

Digjitalizimi i shërbimeve kadastrale në portalin qeveritar e-Albania gjatë vitit 2021 ka sjellë reduktimin e radhëve në sportelet publike, uljen e burokracisë dhe të kohës së shërbimit. Këto iniciativa sollën një rënie prej 77% të kohës së pritjes së shërbimeve kadastrale gjatë periudhës 2017-2021. Të gjitha aktet kadastrale të ofruara nga ASHK (ku përfshihen edhe certifikatat e pronësisë), lëshohen vetëm me nënshkrim dhe vulë elektronike. Gjatë vitit 2021, numri i certifikatave të pronësisë të lëshuara nga ASHK është rritur ndjeshëm.

Numri i certifikatave të pronësisë të lëshuara nga ASHK gjatë vitit 2021 **është 67% më i lartë se** numri i certifikatave të lëshuara gjatë vitit 2020-të.


Pavarësisht rritjes së konsiderueshme të numrit të shërbimeve të ofruara, si dhe lëshimit të certifikatave të pronësisë, mungesa e burimeve njerëzore të specializuara dhe qarkullimi i stafit gjatë këtij viti, ka ndikuar në cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët.

Me qëllim shtimin e përpjekjeve për të adresuar problematikat e trashëguara ende të vazhdueshme në sistemin kadastral, ASHK u bë pjesë si institucion përfitues në projektin IPA 2020 dhe 2021, “Projekti i BE-së për të Drejtat e Pronësisë”. Ky projekt pritet të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në fushën e digjitalizimit të shërbimeve të ASHK-së, duke synuar në radhë të parë adresimin e të gjithë problematikave që gjenerojnë ose bëhen shkak për veprimtari korruptive. Rezultatet thelbësore të pritshme të këtij projekti përfshijnë, ndër të tjera:

- Projektimi i Sistemit Qendror të Informacionit mbi Territorin, i cili përfshin arkitekturën e sistemit, modelin e bazës së të dhënave
- Përmirësimi i të dhënave kadastrale për rreth 500,000 prona të paluajtshme, përfshirë përmirësimin e hartës kadastrale
- Digjitalizimi i të dhënave të Pasurive të Paluajtshme, përfshirë hartën dhe kartelën
- Ofrimi i të gjitha shërbimeve kadastrale vetëm në formë elektronike në format digjital
- Projektimi i procedurave të brendshme
- Sistemi i plotë i monitorimit të riskut.

CERTIFIKATAT E PRONËSISË TË LËSHUARA

127,220	2018
134,736	2019
144,801	2020
241,640	2021



2.6 Shërbimet e transportit rrugor

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor është një histori suksesi në digjitalizimin e shërbimeve të transportit rrugor, i cili ka në plan të parë interesin publik dhe vëmendjen tek nevojat e qytetarit. Ndaj nga 4 shërbime on-line që jepeshin në fund të 2018-s, sot kemi 77 shërbime on-line për qytetarët dhe subjektet, në platformën e qeverisjes digjitale dhe në web.

Falë rikonceptimit dhe sistemeve të reja, për vitin 2021 janë hequr nga sportelet fizike duke kaluar on-line ose eliminuar krejtësisht plot 2,403,603 aplikime. Gjenerimi elektronik i dokumenteve pa pasur nevojë për t'u paraqitur në sportele, gjatë vitit 2021, prodhoi 344,599 dokumente me vulë digjitale, duke u kursyer qytetarëve dhe bizneseve 17,229,950 km rrugë, 1,206,097 litra karburant dhe 28,717 ditë pune.

Kjo u bë e mundur falë investimeve gjithëpërfshirëse si në infrastrukturën fizike ashtu dhe në infrastrukturën digjitale. Shpenzimet për sisteme operative dhe pajisje informatike rezultuan 3,3% më të larta në vitin 2021 krahasuar me vitin 2018. Shifër që flet për një transformim epokal të Automotorizimit Shqiptar dhe lehtësim të shërbimeve për qindra e mijëra drejtues mjetesh.

Investimet përmirësuan mjediset, teknologjinë, krijuan sisteme të reja, apo përmirësuan sistemet ekzistuese, ndërlidhën sistemet me njëri – tjetrin, në formë digjitale në vitin 2021, duke liruar radhën në sportele dhe duke u kursyer qytetarëve 109,343 ditë pune ose 61,158,843 km rrugë dhe 4,281,122 litra karburant.

Në vitin 2021, për 60 lloj shërbimesh që ofron DPSHTRR përfituan nëpërmjet portalit *e-Albania* plot 1,523,195 shërbime qytetarë dhe biznese.

Ky revolucion digjital në shërbimet e transportit rrugor, në tërësi për vitin 2021 krahasuar me vitin 2018, u ka kursyer qytetarëve 16.2 milionë euro.

Gjatë vitit 2021 janë kryer 39,467 aplikime on-line në web dhe ndërveprime e asistencë në shërbime për qytetarët dhe subjektet duke u kursyer 687,000 km rrugë, 48,090 litra karburant dhe 1,145 ditë pune.

Gjatë vitit 2021 është zgjeruar me 76% mbulimi i territorit me zyra rajonale (me shtimin e 13 zyrave të reja) duke sjellë më afër qytetarit 347,233 shërbime dhe duke i kursyer 17,361,650 km, 1,215,316 litra karburant dhe 14,468 ditë pune.

Gjatë vitit 2021 janë eliminuar plotësisht rreth 493,708 shërbime në ristrukturimin e 9 praktikave dhe procedurave duke sjellë për qytetarin kursim prej 25,880,243 km, 1,811,619 litrash karburant dhe 65,013 ditësh pune.


1.523.195

**SHËRBIME TË
TRANSPORTIT
RRUGOR JANË
OFRUAR NË
VITIN 2021 PËR
QYTETARËT
DHE BIZNESET
NËPËRMJET
PORTALIT
e-ALBANIA**



GJENERIMI I DOKUMENTEVE ME VULË ELEKTRONIKE



APLIKIME ONLINE NË WEB

SHËRBIMET E OFRUARA
NË ZYRA RAJONALE

ZYRA RAJONALE SHËRBIMESH



Risitë në DSHPTRR në informim, lehtësimin e praktikave, eliminimin apo uljen e tarifave janë si më poshtë:

Informim

- Website tërësisht i ri www.dpshttr.gov.al, me sportel digjital, rindërtim e rikonceptim total si strukturë e imazh;

- Open Data DPSHTRR: Një platformë on-line, e cila mundëson të dhënat statistikore mbi mjetet e regjistruara dhe lejedrejtimet në Shqipëri dhe për të tjera shërbime të ofruara nga DPSHTRR. Feedback i marrë nga operatorët e tregut për vitin 2021 rezultoi me mbi 10,500 faqe të vizituara nga ku 1,318 përdorues kanë pasur akses në 23

- shtete të ndryshme;
- Sistemi i Monitorimit Interaktiv dhe i vazhdueshëm me pajisje teknologjike moderne dhe sallë monitorimi.

Lehtësim praktikash

- Mundësia e rinovimit të lejedrejtimit në çdo

Drejtori Rajonale, pavarësisht vendbanimit të mbajtësit të lejedrejtimit;

- EasyCheck – Kontroll Fizik Lëvizës në ndihmë të flotave të rënda e parqeve me shumë mjete;
- Përmirësim 100% i sistemit e-DM (sistemi operativ i lejedrejtimit). Duke filluar nga

Rikoncepim Shërbimesh përmes thjeshtimit dhe eliminimit të praktikave e procedurave, si edhe uljes ose eliminimit të tarifave	Kursim në litra/karburant	Kursim në distancë (km)	Kursim në kohë (ditë pune)
Kontratë për ndryshim pronësie mjete (në sportele me -70% të tarifës së noterëve dhe kursim lekë/karburant) (kursim kohe, në procedura tek noteri (20 min) dhe kohe në trafik (40 min në trafik vajtje -ardhje))	65,769	939,550	2,349
Heqja e identifikimit fizik (Zerim i tarifës prej 1500 lekësh për 4 shërbime dhe eliminim i shpenzimeve karburant për lëvizjen e mjetit) (kursim kohe në procedura (20 min) dhe kohe në trafik (40 min në trafik vajtje -ardhje))	350,000	5,000,000	12,500
Lejedrejtimi/qarkullimi ndërkombëtare (Vlefshmëria nga 1-3 vjet pa ndryshim tarife (-1,000 lekë) dhe kursim lekë/karburant) (kursim kohe në procedura (20 min) dhe kohe në trafik (40 min në trafik vajtje -ardhje, për secilin nga dy vitet e ardhshme)	90,310	1,290,133	3,225
Zgjatje e afatit të vlefshmërisë të Certifikatave të Transportit Ndërqytetas dhe Ndërkombëtar: nga 1 në 5 vjet (kursim kohe në procedura (20 min) dhe kohe në trafik (40 min në trafik vajtje -ardhje, për secilin nga 4 vitet e ardhshme)	19,320	276,000	690
Lejedrejtimi Duplikat pa qenë nevoja për raport mjekësor, as foto të re, riprodhohet patenta me afatet ekzistuese. (kursim kohe në procedura mjekësore (60 min) dhe në trafik gjatë spostimit për kontrolle mjekësore (10 km në qytet: 40 min)	1,195	17,060	355
Aplikim on-line për Certifikatë Ndërkombëtare Mallra për të Tretë e me Qira, Certifikatë Transporti Multilateral vendet ECMT/CEMT dhe Certifikatë Transporti Ndërkombëtar i Udhëtarëve. Nga 3 herë paraqitet vetëm 1 herë në sportel (kursim kohe në procedura (20 min) dhe kohe në trafik (40 min në trafik vajtje-ardhje, për secilin nga 2 herët që eliminohen)	51,100	730,000	1,825
Rinovimi i Dëshmisë së Taksistit çdo 5 vjet nga çdo 2 vjet që ishte, (kursim kohe procedura (20 min) dhe kohe në trafik (40 min vajtje-ardhje, për secilin 1.5 herët e ardhshme)	8,925	127,500	319
Heqja e identifikimit fizik për çdo ndryshim pronësie (Zerim i tarifës prej 1,500 lekësh dhe eliminim i shpenzimeve të karburantit të lëvizjes me mjet) (kursim kohe në procedura (20 min) dhe kohe në trafik (40 min në trafik vajtje-ardhje))	210,000	3,000,000	7,500
Kalimi i ofrimit të shërbimit të Kontrollit Teknik tek DPSHTRR me risitë (pa ndryshim tarifash): Mjetet e përdorura kryejnë kolaudimin 1 herë në 2 vjet (nga çdo 1 vit që ishte më parë) dhe mjetet taksi/autoshkollë dhe mjetet transport mallrash/udhëtarësh kryejnë kolaudimin 1 herë në vit (nga çdo 6-muaj që ishte më parë). Kursim kohë shërbimi (20 min) dhe kohë në trafik (40 min vajtje-ardhje).	1,015,000	14,500,000	36,250
Totali	1,811,619	25,880,243	65,013

muaji janar 2020, është zbatuar sistemi i ri e-DM, me gjithë modulet e lejedrejtimit nga aplikimi i kandidatit te lëshimi i patentës e certifikatave), një përmirësim për të gjitha procedurat on-line. Viti 2020 shënon revolucionin digjital në testimin teorik dhe praktik, në perfeksionimin e sistemeve për lejedrejtimin duke përfshirë programe, pajisje, rrjete e shërbime on-line dhe duke rritur kapacitetin e prodhimit e lëshimit të lejedrejtimit dhe të hapësirave fizike e virtuale për testim;

- Rishikim të testit të teorisë (Kat. B), e publikuar on-line. U eliminuan 1,199 fjali ngatërrestare dhe u korrigjuan 1,848 fjali me gabime. Nga 4,864 fjali, testi tani gjenerohet me objektivitet nga 3,665 fjali, (-25%) duke lehtësuar kalueshmërinë pa cenuar sigurinë;
- Instalimi i sistemeve të menaxhimit të radhës dhe transferimi i Dosjes me 1 StopShop, në Drejtoritë Rajonale;

Ulje tarifash


- Zerimi i tarifave të regjistrimit të mjeteve me motor elektrik që nga 17 tetor 2019 (ishin 7,500 lekë) falë akteve normative nga MIE dhe DPSHTRR;
- Amortizimi i paketës së taksave vjetore të mjeteve, tarifa e përjashtime;
- CAP - Certifikatë Aftësie Profesionale (Zgjatja e afatit me uljen e tarifës me -43%);
- Nga 15 gusht 2019, personalizimi/lëshimi i kartonit të ri të "Lejedrejtimit" realizohet në vetëm 30 minuta për Tiranën (45% e vendit), nga 15-20 ditë që ishte pritja në nëntor 2018;
- Tarifë e reduktuar (-43%) për lejedrejtimet me afat të kufizuar, 3-5 vjeçare dhe me arsye shëndetësore për lejedrejtimi B;

DPSHTRR-ja për herë të parë realizoi ofrimin e shërbimeve në transportin ndërqytetës nëpërmjet aplikimit *on-line* në platformën *e-Albania* dhe përpunimin e dokumentacionit në sistemin e brendshëm *e-Transport*.

Si qasje parandaluese kundrejt fenomenit të korrupsionit, në funksion të rritjes së transparencës dhe fuqizimit të infrastrukturës elektronike, në veprimtarinë e brendshme, DPSHTRR ka ndërmarrë edhe planveprimet si:

- Identifikimi/gjurimi i rasteve korruptive dhe praktikave abuzive, duke i adresuar në faqen zyrtare të web-it të DPSHTRR-së, nëpërmjet rubrikës "Denonco akte korruptive apo abuzive nga punonjësit tanë";
- Krijimin e organeve të caktuara të vendosura në zbatim të ligjit siç janë: Njësia përgjegjëse e sinjalizuesve (Njësia që merr në shqyrtim kërkesën e sinjalizuesve lidhur me rastet e korrupsionit);
- Programi i Transparencës edhe Platforma e Denoncimeve, ku detajohen kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publik, mënyrën e publikimit, si dhe parashikimet ligjore prej të cilave lind detyrimi për publikim;
- Komunikim i drejtpërdrejtë i shqetësimeve mbi shërbimin në DPSHTRR edhe nëpërmjet "Platformës së Bashkëqeverisjes" si edhe platformës e-Albania me emërtimin "Kërkesë/ Ankesë në e-Albania";
- Pyetëtori për cilësinë e shërbimit në sportel, në rubrikën "Zëri Yt Dëgjohet", e cila synon identifikimin dhe trajtimin e ankesave/ problematikave të qytetarëve për shërbimet në sportelet e DPSHTRR-s, lehtësimin në marrjen e shërbimit, përmirësimin e shërbimeve, rritjen e besueshmërisë së qytetarëve ndaj DPSHTRR-së, ku gjatë viteve 2020/2021 janë kryer 11,935 anketime;

Në kuadër të qasjes parandaluese të korrupsionit si dhe rritjes së transparencës dhe fuqizimit të infrastrukturës elektronike, DPSHTRR ka ndërmarrë dhe vijon të zbatojë veprime konkrete në drejtim të sintetizimit të shërbimeve, krijimit të shërbimeve tërësisht të reja, të cilët synojnë lehtësime për qytetarët/subjektet por edhe formalizimin e shërbimeve deri para disa vitesh informalë. Gjithashtu, është realizuar në praktikë, rritja e rendimentit dhe e standardizimit të burimeve njerëzore në ofrimin e shërbimit.



3. MEKANIZMAT E ANKESAVE DHE HETIMI ADMINISTRATIV I KORRUPSIONIT

3.1 Mekanizmat e ankesave digjitale dhe hetimi administrativ i korrupsionit

Mekanizmat e ankesave dhe hetimi administrativ në luftën kundër korrupsionit ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen e besimit, në efektivitetin e të gjitha politikave dhe mekanizmave antikorrupsion. Në Shqipëri, janë zbatuar tipologji të ndryshme të mjeteve të denoncimit digjital. Platformat e denoncimeve on-line, sistemet e automatizuara të raportimit në terren, po marrin rëndësi thelbësore për të angazhuar aktivisht qytetarët që të denoncojnë korrupsionin.

Analizat e të dhënave të gjeneruara përmes këtyre mjeteve janë kyçe për objektin e zgjerimit të hetimit administrativ nga autoritetet përkatëse dhe për prodhimin e provave bindëse e të mjaftueshme për agjencitë ligjzbatuese dhe prokurorinë, për të ndjekur sjelljet kriminale që lidhen me korrupsionin.

Me synimin për të arritur rezultate të prekshme në hetimin e korrupsionit, këto sisteme varen shumë nga angazhimi i plotë i institucioneve zbatuese për t'i shfrytëzuar ato sa më mirë, si dhe për të zbatuar llogaridhënien ndaj abuzuesve të mundshëm. Gjithashtu, reagimet e qytetarëve janë thelbësore në ndërtimin e besimit rreth këtyre platformave.



85 MASA ADMINISTRATIVE TË REKOMANDUARA
69% E ANKESAVE DHE DENONCIMEVE I JANË DËRGUAR
“e-ANKESAT” NË PLATFORMËN E PROKURIMIT
90 HETIME MË PROAKTIVE TË POLICISË SË
30,477 ANKESA TË MARRA PËRMES P



GJET
KRYE

60 BAZA TË DHËNASH SHTETËRORE JANË ADMIN
RRITJA E KAPACITETEVE PËRMES HYRJES NË FUQI TË
31% E SHKELJEVE I REFEROHEN RASTEVE TË SHPË
7 SISTEME TË REJA DIGJITALE TË ZI

UARA PËR ZYRTARËT E 8 INSTITUCIONEVE
JAR KOORDINATORIT KOMBËTAR ANTIKORRUPSION
PUBLIK JANË BËRË PLOTËSISHT FUNKSIONALE
Ë SHTETIT KRAHASUAR ME VITIN 2020-TË
PLATFORMËS SË BASHKËQEVERISJES

TJET
SORE

ISTRUAR OSE AKSESUAR NGA POLICIA E SHTETIT
LIGJIT TË RI PËR AGJENCINË E MBIKQYRJES POLICORE
ËRDORIMIT TË DETYRËS OSE KORRUPSIONIT PASIV
BATUARA NGA POLICIA E SHTETIT

Sistemi i denoncimeve të Koordinatorit Antikorrupsion

Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit është përgjegjëse nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion për marrjen e denoncimeve dhe hetimin e rasteve të nisura ose të përcjella nga koordinatorët antikorrupsion¹⁴. Gjatë vitit 2021, **69% e numrit të përgjithshëm të ankesave të pranuar nga Koordinatori Kombëtar kundër korrupsionit janë marrë në rrugë digjitale dhe më shumë se 80% e tyre i referohen çështjeve të pronësisë.**

Në përpjekje për të shfrytëzuar digjitalizimin si një mjet efektiv kundër korrupsionit, gjatë vitit 2021, Koordinatori Kombëtar Antikorrupsion i ka hapur rrugë ngritjes së Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Denoncimeve për Korrupsion. Me zgjerimin e rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, ky sistem është thelbësor në sigurimin e llogaridhënies dhe të reagimeve në kohë reale për qytetarët.



189
ANKESA/DENONCIME PËR
RASTE KORRUPSIONI

118
ANKESA/DENONCIME TË MARRA PËRMES
PLATFORMËS SË BASHKËQEVERISJES DHE
PORTALIT "DENONCONI KADASTRËN"



PAS TRAJTIMIT TË KËTYRE DENONCIMEVE, KOORDINATORI KOMBËTAR ANTIKORRUPSION KA MARRË MASAT E MËPOSHTME:

85
MASA ADMINISTRATIVE
PËR ZYRTARË PUBLIKË NË 8
INSTITUCIONE

12
KALLËZIME PENALE PËR 4 ZYRTARË TË
INSTITUCIONEVE TË NDRYSHME, TË GJITHA
TË REGJISTRUARA NGA PROKURORIA
PËRKATËSE DHE HETIMI PËR TO VAZHDON

11
GJOBA
ADMINISTRATIVE
PËR 4 ZYRTARË

HETIMI PËR RASTET E MËSIPËRME KA ZBULUAR MODELE SHKELJESH DHE VEPRASH
PENALE NË DISA PROCESE APO VEpra QË LIDHEN ME KORRUPSIONIN, SI P.SH:

TRANSFERIMI I
PASURISË

LEGALIZIMI I
NDËRTIMEVE
PA LEJE NË
KUNDËRSHTIM
ME LIGJIN

NDËRTIMET PA
LEJE NË ZONAT
E MBROJTURA

FALSIFIKIMI I
DOKUMENTEVE
TË GJENDJES
CIVILE

FALSIFIKIMI I
DOKUMENTEVE
TË ARSIMIT

FALSIFIKIMI I
DOKUMENTEVE
TË PRONËSISË


14. <https://drejtesia.gov.al/denonco/>

Platforma e Bashkëqeverisjes

Platforma e Bashkëqeverisjes, e administruar nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, përfaqëson një dritare digjitale për të qenë më pranë qytetarëve dhe biznesit, përmes përfshirjes në politikëbërje, sigurimit të pjesëmarrjes në procedurat administrative të vendimmarrjes dhe rritjes së llogaridhënies në ofrimin e shërbimeve publike. Funkzioni dhe kompetencat e Platformës së Bashkëqeverisjes u forcuan më tej, me miratimin e ligjit 107/2021 “Për bashkëqeverisjen”, i cili i referohet dhe prezantimit të një seksioni të ri

“Denonco korrupsionin”, si pjesë e integrale e platformës. Nëpërmjet këtij seksioni, platforma ofron një mjet tejet efektiv për të raportuar akte korruptive, akte të supozuara korruptive të kryera ose të mbetura në tentativë.

Gjatë vitit 2021, Platforma e Bashkëqeverisjes ka shënuar konsolidim të dukshëm. Numri i ankesave nga qytetarët dhe bizneset të trajtuara përgjatë vitit ka arritur në 22,747 dhe vlen të theksohet se 8,352 prej tyre kanë marrë zgjidhje.





Numri më i madh i ankesave i përket: fushës së pronësisë me 21%; fushës së financës me 19%; fushës së infrastrukturës dhe energjisë me 10%; fushës së shëndetësisë me 8%; fushës së arsimit dhe rendit publik me 7%. Fushat e tjera kanë një përqindje të vogël ankesash.

Platforma e Bashkëqeverisjes, në paralel me ankesat e biznesit që mbërrijnë në platformë, kujdeset në përditshmëri që kërkesat e biznesit drejtuar institucioneve të administratës qendrore, të ndiqen me përpikëri dhe përgjigjja të merret sipas afateve ligjore e me cilësinë e duhur. Përgjatë vitit 2021, janë trajtuar 1,076 ankesa biznesi dhe zgjidhur 348 prej tyre, si dhe 2,461 kërkesa biznesi dhe kanë marrë përgjigje finale 2,131 prej tyre.

Afatet ligjore të platformës për kthim-përgjigje ndaj qytetarit dhe biznesit janë 10 ditë. Vetëm kur rasti ka nevojë për bashkërendim të punës dhe ndërveprim institucional, platforma merr informacionin për llogari të qytetarit për t'i dhënë zgjidhjen përfundimtare të çështjes dhe afati kohor mund të zgjatet deri në 30 ditë.

Një ankesë që vjen në platformë dhe shënohet si ankesë me elemente korruptive, ndjek procedurën si më poshtë:

1. Kur në Platformën e Bashkëqeverisjes vërehet një ankesë, e cila në përmbajtje të saj përmban elemente korruptive, koordinatori i atashuar pranë një ministrie sinjalizon koordinatorin mbikëqyrës në Kryeministri për këtë ankesë.
2. Koordinatori mbikëqyrës në bashkëpunim me drejtorin e drejtorisë dhe drejtorin e përgjithshëm shqyrtojnë dhe një herë këtë ankesë, për të vendosur nëse rasti përmban elemente korruptive.
3. Kur vlerësohet si rast me elemente korruptive, ai shënohet në sistem dhe nisët për trajtim pranë Njësisë Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë.

E-Ankesat në Prokurimin Publik

Në vitin 2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka zbatuar sistemin e parë digjital të ankesave (e-Ankesat) për paraqitjen dhe menaxhimin e tyre, i cili është plotësisht në funksion që nga tetori 2021. Operatorët ekonomikë mund të depozitojnë ankesat e tyre on-line, duke shmangur procedurat e ndërlikuara, shkurtuar kohën dhe rritur shpejtësinë e ndërveprimit me autoritetet kontraktuese. Ky zhvillim bën të mundur ofrimin e informacionit në kohë reale për të gjitha palët e interesuara, duke përmirësuar ndërveprimin me këto subjekte, rritur transparencën dhe efektshmërinë, ulur kostot, si dhe duke rritur përgjegjshmërinë e Komisionit të Prokurimit Publik ndaj të gjitha palëve.

Portali i Komisionit të Prokurimit jep mundësi kërkimi me filtra të ndryshëm në tri regjistra publikë, regjistrin e ankesave, regjistrin e vendimeve dhe atë të historikut të vendimeve. Gjithashtu, të dhënat e ankesave dhe të vendimeve publikohen bazuar në parimet e Open Data, mbështetur në standardin e OCDS. Sistemi mundëson marrjen e informacionit edhe në format JSON, duke bërë të mundur që organet ligjzbatuese dhe monitoruese, përfshirë këtu APP, KLSH, SPAK dhe Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion, në Ministrinë e Drejtësisë të kenë mundësi të informohen në kohë reale mbi problematikat në prokurimet publike. Gjithashtu, ky sistem jep mundësinë që edhe Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi të ndjekë problematikat e sistemit të prokurimit, duke propozuar kur është e nevojshme nisma për ndryshime ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu, grupet e interesit marrin të drejtën në formatin JSON për përpunimin të dhënave, që u duhen sipas tematikave të ndryshme.

Në vitin 2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka regjistruar 741 ankesa, ndërsa në vitin 2021 numri i tyre ka arritur në 768. Në vitin 2020, nga 601 vendime, 59 janë kundërshtuar në gjykatë; ndërsa në vitin 2021, nga 676 vendime, 53 janë kundërshtuar në gjykatë. Numri i padive ndaj vendimeve të KPP-së tregon një prirje në rënie, pasi përqindja e vendimeve të kundërshtuara në gjykatë për vitin 2020-të është 9.8%, ndërsa për vitin 2021 është 7.8%.

Gjithashtu, është përmirësuar treguesi i kohës së shqyrtimit të ankesave për vitin 2021, duke ulur ndjeshëm numrin e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit. Konkretisht, për vitin 2021 përqindja e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit është ulur në vlerën 10.8 %, ndërsa koha e vendimmarrjes për vitin 2021 është mesatarisht 17 ditë. Lidhur me vendimmarrjet e Komisionit të Prokurimit Publik të ankmuara në gjykatë, rezulton se numri i padive ndaj vendimeve të KPP-së tregon një tendencë në rënie, pasi përqindja e vendimeve të vërejtura në gjykatë për vitin 2020 është 9.8%, ndërsa për vitin 2021 është 7.8%.

Nëpërmjet këtij sistemi, synohet të ulet me dy ditë koha e shqyrtimit të ankesave në sajë të ndërveprimit më të shpejtë me autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë, nëpërmjet sistemit digjital të e-Ankesave. Sfida e së ardhmes mbetet, gjithashtu, digjitalizimi i plotë i arkivës për vitet 2010-2020, çka do të mundësonte analizimin e detajuar të problematikave të dalluara nga organet e shqyrtimit të ankesave ndër vite.

Komisariati Digjital

Komisariati Digjital është platforma kryesore e Policisë së Shtetit, që u jep mundësi qytetarëve të bëhen agjentë të luftës dhe raportimit të korrupsionit. Një ndërveprim digjital i tillë, midis qytetarëve dhe Policisë së Shtetit, qëndron në një mjet të shpejtë komunikimi me qëllim që t'u ofrojë qytetarëve mundësinë për të raportuar në rrugë anonime abuzimet dhe veprimet e paligjshme, duke përfshirë, ndër të tjera, ndërtimet pa leje, vjedhjet apo grabitjet e raste të korrupsionit.

Aplikacioni “Komisariati Digjital”, u krijua me qëllimin që zëri qytetar të dëgjohet dhe që shërbimi i policisë së shtetit në përgjigje të tyre të përmirësohet, falë përdorimit të teknologjisë. Që nga maj 2015, kur ky aplikacion u vu në përdorim për herë të parë rastet e denoncimeve anonime nga qytetarët (parkim i gabuar, ndërtim pa leje, armëmbajtje/dhunë, vjedhje ose raste të korrupsionit) me tekst apo imazh kanë ardhur duke u rritur, çka dëshmon për rritjen graduale të besueshmërisë ndaj këtij aplikacioni.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK GJATË 2021

145


PUNONJËS NDAJ TË CILËVE KA
NISUR PROCEDIMI DISIPLINOR

102

GJOBA PËR PUNONJËS
TË NIVELIT TË LARTË

80

AGJENTË EKONOMIKË KANË
MARRË MASË NDËSHKIMORE




Në portalin e Komisarariatit Digjital në vitin 2021, janë marrë gjithsej 59,166 njoftime, nga të cilat 527 ishin njoftime për korrupsion, krahasuar me 499 të vitit paraardhës.

Vërehet se gjatë vitit 2021 tërësia e denoncimeve në Komisarariat Digjital pësoi ndryshime. Në aplikacion u shtuan dhe dy mundësi “krim mjedisor në tabelë” dhe “dhuna në familje”, si prioritete në punën e policisë. Komisaritati Digjital së fundmi, është rikonceptuar dhe është bërë plotësisht funksional me rubrika të reja dhe me më shumë garanci në mbrojtje të anonimatit të qytetarëve.

Është zgjeruar hapësira për veprimin e qytetarëve, të cilët ndër të tjera mund të vëzhgojnë edhe reagimin e Policisë së Shtetit ndaj ankesës a kërkesës së tyre, vetëm më një klik nga telefoni celular ose kompjuteri.

Njësitë policore, që kanë marrë numrin më të madh të ankesave janë ato që kanë kontakte të drejtpërdrejta dhe të vazhdueshme me qytetarët, të dalluar si më të rrezikuar nga korrupsioni, të cilat përfshijnë: njësitë e shërbimeve të sigurisë publike me 47%, nga të cilat policia rrugore me 27%; hetimi i krimit me 19%; kontrolli kufitar me 3%.

GJATË 2021, JANË DORËZUAR 59,166 NJOFTIME NGA QYTETARËT PËRMES KOMISARIATIT DIGJITAL




3.2 Hetimi i korrupsionit nga policia dhe mekanizmat e mbikëqyrjes policore

Mekanizmat e denoncimit digjital kanë rol kyç në dallimin e abuzimeve të mundshme nga zyrtarët publikë. Këto platforma janë të pajisura me mekanizma të integruar gjurmues që ndikojnë në uljen e prirjes së punonjësve publikë dhe policisë për të lënë pas dore ose vonuar përgjigjen ndaj qytetarëve, pa lënë gjurmë digjitale në proces. Këto mekanizma përbëjnë një mjet shumë efektiv në hetimin e rasteve të korrupsionit.


Nëpërmjet aplikacionit të Komisarariatit Digjital janë dalluar 643 vepra penale të kryera nga punonjës të shtetit në detyrë, përfshirë veprën e shpërdorimit të detyrës, me 986 autorë të dyshuar, nga të cilët 139 të arrestuar, 823 të proceduar në gjendje të lirë dhe 24 të shpallur në kërkim. Krahasuar me vitin 2020 janë identifikuar 75 vepra penale më shumë nga punonjësit e shtetit në detyrë. Veçanërisht, lidhur me veprën penale të shpërdorimit të detyrës, në total janë 137 vepra penale me 209 autore, zbuluar 128.

Në 2021, janë 95 vepra penale të korrupsionit të



INSTITUCIONI	NUMRI AUTORËVE TË VEPRAVE PENALE TË DYSHUAR
SHËRBIMI PËRMBARIMOR	2
AGJENCIA KOMBËTARE E INFORMACIONIT PRIVAT	1
KOMPANITE PRIVATE IT	1
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS	13
OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE	17
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE	3
OPERATORI PRIVAT EKONOMIK	2
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT	3
KLUBI SPORTIV "LUFTËTARI"	1
FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT	3
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR	7
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE	15
NOTERE	3
INSPEKTORATET E MBROJTJES SË TERRITORIT	13
SPITALET (MJEKËSIA)	1
ISHS	1
DREJTORITË ARSIMORE	1

NË VITIN 2021, JANË MIRATUAR 7 SKEMA TË REJA ELEKTRONIKE NGA POLICIA E SHËTETIT



POLICISË SË SHËTETIT I ËSHTË DHËNË AKSES NË 2 BAZA TË DHËNASH

REGJISTRI QENDROR I LLOGARIVE BANKARE

SISTEMI I BAZËS SË TË DHËNAVE PËR TRAFIKUN DETAR

ndjekura nga Policia e Shtetit më shumë, krahasuar me vitin 2020.

Gjithashtu, janë regjistruar dhe hetuar 343 raste hetimesh proaktive për krime në fushën e korrupsionit, 90 më shumë krahasuar me vitin 2020.

Hetimi Proaktiv nënkupton përdorimin e metodave speciale të hetimit të veprave penale në fushën e korrupsionit. Mjetet digjitale të përdorura në hetimet proaktive ndihmojnë dhe lehtësojnë sigurimin e provave gjatë hetimeve me metoda speciale të hetimit. Në hetimin proaktiv procesi i mbledhjes së provave kryhet njëkohësisht me lindjen e dyshimit për kryerjen e veprës së dyshuar penale, si dhe hetimet që nisen nga prokurori në mungesë të një kallëzimi ose çdo hetim, i cili është dukshëm më i zgjeruar se kallëzimi origjinal.

Gjatë vitit 2021, janë përmbyllur me sukses në fushën e antikorrupsionit 17 operacione policore, ku janë përfshirë 92 autorë të dyshuar, nga të cilët 58 janë ndaluar.

Hetimet e kryera nga Policia e Shtetit në fushën e antikorrupsionit përfitojnë në masë të madhe nga

mjetet e ndryshme digjitale që përdorin. Zgjerimi i hetimeve kërkon që Policisë së Shtetit t'i jepet qasje konkrete në informacione dhe të dhëna në lidhje me autorë të mundshëm në sisteme dhe baza të ndryshme të dhënash shtetërore. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka në funksion 36 sisteme, prej të cilave 7 janë zbatuar gjatë vitit 2021. Nga 22 baza të dhënash jashtë sistemit të Policisë së Shtetit, policisë u është dhënë qasje në dy prej tyre për herë të parë gjatë këtij viti. Në të gjitha rastet janë zbatuar masa mbrojtëse specifike për të shmangur shpërdorimin.

Gjithashtu, janë vënë në funksion të plotë mjete të tjera digjitale për të frenuar korrupsionin në fushat më të ndjeshme të Policisë së Shtetit. Gjatë vitit 2021, shërbimit të Policisë Rrugore iu shtuan 6 radarë të tjerë automatik, duke e çuar në 14 numrin total të tyre. Pajisja me radarë automatik ka bërë të mundur uljen e kontaktit të drejtpërdrejtë të punonjësit të policisë me drejtuesit e mjeteve, duke zvogëluar mundësinë e shfaqjes së korrupsionit të vogël në këtë fushë.

Në total, janë dënuar **15,261 drejtues mjete** për mosrespektim të shpejtësisë, si dhe janë pezulluar

2,773 lejedrejtimi për tejkalim të normave të shpejtësisë.

Radari automatik dallon në kohë reale segmentin rrugor ku ka ndodhur shkelja, mjetin që ka kryer shkeljen dhe punonjës të policisë në vendngjarje. Ky modul ndihmon ndjeshëm në shmangien e korrupsionit nga punonjësit e Policisë Rrugore, pasi e gjithë vendimmarrja pasqyrohet on-line dhe mbikëqyrësi vëzhgon në kohë reale zbatimin e ligjit nga punonjësit e policisë rrugore në detyrë.


Referuar rasteve të korrupsionit aktiv të denoncuar nga shërbimet e Policisë Rrugore, rezultoi se gjatë vitit 2021 janë dalluar dhe raportuar në prokurori gjithsej 44 të tilla.

Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave është riorganizuar së fundmi duke u shndërruar në 'Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore', përmes miratimit të një ligji të ri për funksionimin e agjencisë, ligji nr. 128/2021.


Për vitin 2021, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore ka kryer 43 inspektime të planifikuara në planin vjetor dhe 67 inspektime të paplanifikuara, të cilat janë nisur nga ngjarje të ndryshme të ndodhura, raportime mediatike dhe çështje të raportuara nga qytetarët apo institucione të ndryshme. Nga hetimi administrativ i ankesave dhe inspektimet e kryera, rezultoi se në 7 raste, shkeljet ishin të karakterit kriminal, materialet referuese të të cilave iu dërguan prokurorisë për 14 persona. Ndërsa, në raste të tjera, shkeljet e dalluara ishin të karakterit administrativ dhe për 288 punonjës policie, i është sugjeruar Drejtorisë së Standardeve Profesionale të Policisë së Shtetit për hetim disiplinor.

Bazuar në punën mbikëqyrëse dhe hetimore të kryer nga Agjencia, gjatë vitit 2021, 31% e të gjitha shkeljeve i referohen "shpërdorimit të detyrës" ose "korrupsionit pasiv". Këto të dhëna dëshmojnë për fuqizimin e gjithë veprimtarisë hetimore të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, me qëllim forcimin e integritetit të strukturave policore në Shqipëri.

RADARËT AUTOMATIK, SHPËRNDARJA NË VEND



VENDI	NR. RADARËVE
KOMISARIATI RAJONAL I POLICISË RRUGORE TIRANË	2 RADAR
SEKTORI POLICISË RRUGORE DURRËS	1 RADAR
SEKTORI POLICISË RRUGORE ELBASAN	1 RADAR
SEKTORI I POLICISË RRUGORE KORÇË	1 RADAR
SEKTORI POLICISË RRUGORE FIER	1 RADAR
SEKTORI I POLICISË RRUGORE VLORË	1 RADAR
SEKTORI I POLICISË RRUGORE GJIROKASTËR	1 RADAR
SEKTORI I POLICISË RRUGORE LEZHË	1 RADAR
SEKTORI I POLICISË RRUGORE SHKODËR	1 RADAR
NJËSIA PËR KONTROLLIN E AUTOSTRADAVE	1 RADAR



4. PRAKTIKAT E MIRA PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE DHE NDËRGJEGJËSIMIN PËR KORRUPSIONIN NË EPOKËN DIGJITALE

4.1 Ngritja e mundësive

Efektshmëria e politikave antikorrupsion qëndron në integritetin dhe përshtatshmërinë e burimeve njerëzore të angazhuara në luftën kundër korrupsionit. Ritmi gjallërues i shndërrimit digjital duhet të shoqërohet me forcimin e mundësive të administratës publike për shfrytëzimin sa më të mirë të mjeteve të tilla.

Gjatë vitit 2021, pavarësisht kufizimeve të diktuara nga pandemia, institucione të administratës publike shqiptare në bashkëpunim me partnerë

ndërkombëtarë dhe vendas, janë përfshirë në trajnimin e stafit të tyre mbi praktikant antikorrupsion e kundër evazionit, si dhe në ngritjen e mjeteve të reja digjitale që i shërbejnë këtij qëllimi.

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) dhe institucione të tjera të administratës publike, përdorin mjete digjitale me qëllim ngritjen e kapaciteteve për webinarë dhe platforma virtuale të konferencave. Gjatë vitit 2021, ASPA ka ofruar një sërë trajnimesh të përqendruara tek antikorrupsioni, deklarimi i pasurisë, menaxhimi i riskut dhe roli i inspektorateve në luftën kundër korrupsionit.

1,000 OPERATORË EKONOMIKË & AUTORITETE KONTRAKTORE JANË TRAJNUAR NGA KOSOV
RRJETI I KOORDINATORËVE ANTIKORRUPSION U ZGJERUA NË 44 INSTITUCI
3,886 ZYRTARË PUBLIKË JANË TRAJNUAR NGA A
20 TRAJNIME TË DEDIKUARA PËR PUNONJËSIT E POLICIS

GJET
KRYE

31,471 TATI MPAGUES DHE 3,433 KONTABILISTË JANË TRAJNUAR DU
4 SHKOLLA TË MESME ZBATOJNË PROJEKTIN PILOT PËR FUTJEN E NJË MO
VITI I TRETË RADHAZI I BASHKË-ORGANIZIMIT TË FUSHATËS NDË
ËSHTË NGRITUR NJË PLATFORMË E RENDËR

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK PËR PËRDORIMIN E SISTEMIT TË ANKESAVE ELEKTRONIKE
 ËNDORROR, KRAHASUAR ME 17 INSTITUCIONE NË VITIN 2020
 NE NË NIVEL QENDROR, KRAHASUAR ME 17 INSTITUCIONE NË VITIN 2021
 SPA PËR ANTIKORRUPSIONIN GJATË VITIT 2021
 E SË SHITETIT MBI MJETET E HETIMIT TË KRIMIT EKONOMIK

TJET
 SORE

KE MUNDËSUAR ZBATIMIN E PLOTË TË REFORMËS SË FISKALIZIMIT
 DULI MBI ANTIKORRUPSIONIN NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR
 RGJEGJËSUESE PËR ANTIKORRUPSIONIN "JAVA E INTEGRITETIT"
 RVEPRIMI DIGJITAL "DENONCO KADASTRËN"

KURRIKULA E KONSOLIDUAR E TRAJNIMIT KUNDËR KORRUPSIONIT

22 PIKA KONTAKTI NË TË GJITHA MINISTRITË TË TRAJNUARA SI EDHE STAFI TEKNIK I MINISTRISË SË DREJTËSISË

3,886
ZYRTARË TË TRAJNUAR

7
MODULE BAZË TRAJNIMI
MBI ANTIKORRUPSIONIN

Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, ka organizuar trajnime të thelluara dhe ka fuqizuar kurrikulën kundër korrupsionit për stafin teknik të nëpunësve civilë të Ministrisë së Drejtësisë dhe Rrjetin e Pikave Kyçe Antikorrupsion, në mbi 22 institucione qendrore dhe të pavarura. Për plotësimin e këtij treguesi, Ministria e Drejtësisë është ndihmuar nga Projekti i Asistencës Teknike të Bashkimit Evropian për Luftën Kundër Korrupsionit dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. Ky cikël trajnimi u zhvillua në periudhën maj-dhjetor 2021.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit ka zgjeruar Rrjetin e Koordinatorëve Antikorrupsion, nga 17 në 44 institucione në nivel qendror dhe drejtoritë rajonale të Agjencisë Kombëtare të Kadastrës, Operatorit të Shërbimeve Shëndetësore, Arsimit Parauniversitar dhe spitaleve rajonale. Gjatë vitit 2021, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë Kombëtare Italiane Kundër Korrupsionit (ANAC) ka organizuar kurse trajnimi të synuara për koordinatorët antikorrupsion në çështje të ndryshme aktuale, që lidhen me luftën kundër korrupsionit, përfshirë dhe përdorimin e mekanizmave digjitalë.


Oficerët e Policisë së Shtetit kanë marrë pjesë në trajnime të specializuara për hetimin e krimit ekonomik. Janë zhvilluar **20 seanca trajnimi**, sipas Planit të Trajnimit të Policisë së Shtetit, me tema të tilla si krimi ekonomik, hetimi i pasurisë dhe pastrimi i parave.

Në fushën e prokurimit publik, rreth **1,000 operatorë ekonomikë dhe autoritete kontraktore janë trajnuar nga Komisioni i Prokurimit Publik për përdorimin e Sistemit të Ankesave Elektronike**. Komisioni i Prokurimit Publik ka organizuar 6 trajnime në bashkëpunim me OECD/SIGMA dhe 13 programe trajnimi në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës për zhvillimin e mëtejshëm të aftësive profesionale të stafit të tyre.

TEMAT E TRAJNIMEVE

TË ORGANIZUARA NGA KOORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT NË BASHKËPUNIM ME ASISTENCËN TEKNIKE TË BE-SË


- PLANIFIKIMI, PROGRAMIMI STRATEGJIK PËR ANTIKORRUPSIONIN
- ETIKA DHE INTEGRITETI
- VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT
- PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT
- SINJALIZIMI DHE MBROJTJA E SINJALIZUESVE



TEMAT E TRAJNIMEVE

PËR RRJETIN E KOORDINATORËVE ANTIKORRUPSION

- MENAXHIMI I ANKESAVE DHE DENONCIMEVE
- PËRMIRËSIMI I PLANEVE ANTIKORRUPSION
- ZHVILLIMI I ANALIZËS PËR SEKTORËT E PRIRUR NDAJ KORRUPSIONIT
- FOKUSI I PROKURIMIT PUBLIK NË PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT



Sfidat që mbeten për t'u adresuar në periudhën në vijim qendrojnë në forcimin e mundësive të administratës publike, për të dalluar, gjurmuar e hetuar rastet korruptive dhe për të përmirësuar aftësitë digjitale të të gjithë punonjësve të administratës publike, në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Gjithashtu, synohet rritja e kapaciteteve për të zhvilluar e zbatuar kodin e sjelljes dhe rregulloret e integritetit për punonjësit e sektorit publik, si pjesë e përpjekjeve të përbashkëta për të luftuar përjashtimin, pabarazinë e mosbesimin në institucionet publike.

4.2 Ndërgjegjësimi

Zbatimi efektiv i politikave antikorrupsion ka parashikuar angazhimin proaktiv të institucioneve publike, shoqërisë civile dhe qytetarëve për të luftuar pa kompromis korrupsionin, si dhe për të nxitur zhvillimin hap pas hapi të një kulture integriteti. Gjatë vitit 2021, janë eksploruar qasje të ndryshme, përfshirë përdorimin e mjeteve digjitale, për të komunikuar më afër me shoqërinë civile, komunitetin e biznesit, qytetarët dhe shoqërinë në përgjithësi.

Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit ka promovuar përmes faqes së saj të internetit dhe rrjeteve sociale Rrjetin e Koordinatorëve Antikorrupsion, ku një seksion i veçantë është krijuar për paraqitjen e raporteve në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë,¹⁵ si dhe një referencë specifike i është bërë koordinatorëve antikorrupsion të caktuar në agjenci të ndryshme që mbartin një rrezik të lartë korrupsioni në faqet e tyre përkatëse të internetit.¹⁶

Në nëntor 2021, Platforma e Bashkëqeverisjes ka prezantuar portalin “Denonco Kadastrën” si një mjet të ri ndërveprimi digjital që nxit raportimin e rasteve, kur zyra e kadastrës pengon dhe vonon ofrimin e shërbimit. Këto i dërgohen drejtpërdrejt Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë për hetim të thelluar. Kjo

15. <https://drejtesia.gov.al/denonco/>

16. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit <https://aku.gov.al/rrjeti-i-koordinatoreve-antikorrupsion/>, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve <https://www.tatime.gov.al/c/8/65/525/koordinatori-i-rrjetit-anti-korrupsion>, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor <https://www.dpshttr.al/kontakto-koordinatorin-anti-korrupsion>, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor <http://oshksh.gov.al/koordinator-antikorrupsion/>,

36,559

SHKRESA U JANË DËRGUAR
TATIMPAGUESVE PËR T'I
INFORMUAR MBI DETYRIMET
LIGJORE TË REJA QË LINDIN
PËR ZBATIMIN E LIGJIT TË
FISKALIZIMIT.

31,471

TATIMPAGUES JANË
TRAJNUAR SI DHE 3,433
KONTABILISTË.

8,655

VIZITA TEK TATIMPAGUESIT
E RINJ PËR TË OFRUAR
TRAJNIME DHE
INFORMACION

217,415

TATIMPAGUES TË ASISTUAR
PERSONALISHT

platformë ka rezultuar efektive në marrjen e ankesave nga qytetarët dhe në dallimin e shpejtë të shpërdorimeve.

Në sektorin financiar, viti 2021 ka qenë kritik për sigurimin e zbatimit të plotë të procesit të fiskalizimit. Për këtë qëllim, Administrata Tatimore ka drejtuar një fushatë ndërgjegjësuese në shkallë të gjerë për të informuar tatimpaguesit e profesionistët kontabël mbi çdo aspekt të zbatimit të këtij procesi dhe për të shmangur abuzimin nga inspektorët tatimorë.

Komisioni i Prokurimit Publik publikoi buletine mujore dhe raporte vjetore që paraqesin të dhëna të gjeneruara nga Sistemi i Ankesave Elektronike. Me qëllim rritjen e transparencës dhe ndërgjegjësimin për mjetet digjitale të disponueshme dhe funksionimin e tyre, buletinet u shpërndahen të gjithë operatorëve ekonomikë të regjistruar në bazën e të dhënave të KPP-së dhe gjenden në faqen e internetit. Raportet vjetore përfshijnë statistika në lidhje me ankesat e paraqitura nëpërmjet regjistrit on-line, ecurinë e shqyrtimit të ankesave, si dhe vendimet e KPP-së për ankesat. Portali i KPP-së është i aksesueshëm edhe për personat me aftësi të kufizuara.

The background of the page is a vibrant orange color, overlaid with a pattern of numerous thin, parallel blue lines that create a sense of motion and depth. The lines are oriented diagonally, sloping downwards from left to right. The density of the lines is higher on the left side and gradually decreases towards the right, creating a perspective effect.

PËRMBLEDHJE



ARRITJET KRYESORE PËR VITIN 2021 DHE SFIDAT NË VIJIM

- Viti 2021 ka shënuar zhvillime strukturore të rëndësishme në drejtim të luftës kundër korrupsionit. Kapacitetet institucionale në luftën kundër korrupsionit janë fuqizuar përmes krijimit për herë të parë të Drejtorisë së Përgjithshme kundër Korrupsionit, përgjegjëse për vënien në jetë të politikave parandaluese, ndëshkuese e ndërgjegjësuese kundër korrupsionit dhe zgjerimit të Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit.
 - Rritja e ndërveprimit midis qytetarëve dhe administratës publike përmes mjeteve digjitale është shoqëruar me ulje të ndjeshme të burokracive, kohës së pritjes, kostos së ofrimit të shërbimit për qytetarët, dhe për pasojë, pakësimit të korrupsionit në sportele. Në periudhën pasardhëse, synohet rritja e nivelit të qasjes në këto shërbime si dhe matja e efektshmërisë së tyre, duke u përqendruar në zvogëlimin e hapësirave të mundshme korruptive, përmes mbylljes së sporteleve fizike. Në kuadër të revolucionit digjital dhe mbylljes së sporteleve, lëvrimi i shërbimeve publike me cilësi e në kohë, me nënshkrim dhe vulë elektronike, të cilat vëzhgohen në kohë reale garanton se asnjë shërbim nuk mbetet në dorë të zyrtarëve të papërgjegjshëm.
 - Autoritetet shëndetësore fuqizuan mjete të reja digjitale për përmirësimin e performancës së sistemit shëndetësor, përmes vëzhgimit në kohë reale të ofrimit të shërbimit ndaj qytetarëve. Të dhënat e plota në formatin digjital ofrojnë mundësinë e vëzhgimit të procedurave të ndjekura nga mjekët, reduktojnë hapësirat për shkelje dhe korrupsion dhe sigurojnë përputhshmërinë me protokollet e përcaktuara. Ofrimi i shërbimeve digjitale në sistemin shëndetësor ka reduktuar gjithashtu në mënyrë rrënjësore kohët e pritjes për ekzaminime dhe konsulta të specializuara.
- Sfidë në vijim mbetet rritja e shtrirjes së përdorimit të shërbimeve digjitale në zonat rurale me qëllim njësimin dhe sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse në kujdes shëndetësor.
- Mjetet e reja digjitale në sistemin parauniversitar kanë siguruar komunikim të shpejtë dhe llogaridhënie nga ana e autoriteteve arsimore dhe mësuesve, duke hedhur themelet e një qasjeje sistemike për komunikimin mësues-nxënës-prind. Sistemet digjitale të ndërtuara në të gjitha ciklet e arsimit sigurojnë shërbim të shpejtë, cilësor, transparent, duke shmangur korrupsionin, nepotizmin dhe ndërhyrjet politike në punësim.
 - Vënia në jetë e të gjithë gamës së mjeteve digjitale në funksion të disa sektorëve kyç, të ndjeshëm ndaj korrupsionit ka mundësuar në vijimësi vëzhgimin, gjurmueshmërinë dhe llogaridhënie të shtuar në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe bizneseve. Përgjatë vitit pasardhës, përpjekjet duhet të përqendrohen në drejtim të zhvillimit të mekanizmave të dallimit dhe menaxhimit të riskut në sektorë si prokurimet publike, tatimet, shëndetësia, arsimit, pronat, transporti rrugor, etj. Gjithashtu, do të synohet zhvillimi dhe zbatimi i mëtejshëm i planeve të integritetit me qëllim dallimin e risqeve të integritetit dhe sigurimin e një përgjigjeje institucionale të përshtatshme për secilin risk.
 - Përdorimi i mjeteve digjitale në prokurimin publik ndikon pozitivisht në rritjen e transparencës në procesin e prokurimit publik si edhe në reduktimin e risqeve për abuzim në zhvillimin e procedurave të prokurimit. Pavarësisht arritjeve të deritanishme, është e domosdoshme që të vijohet puna për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimit në drejtim të sigurimit të një shërbimi të pandërprerë dhe me integritet në procedurat

- e prokurimit. Sistemet digjitale të prokurimit publik ofrojnë një bazë solide për të vëzhguar anomalitë në procesin e prokurimit si në fazën përpara lidhjes së kontratës, por edhe në fazën e monitorimit të menaxhimit të kontratave publike. Në këtë mënyrë, i është hapur rrugë kryerjes së analizave të thelluara të proceseve që mbartin risk të lartë në këtë sektor.
- E-Shërbimet tatimore dhe fiskalizimi kanë shndërruar komunikimin e administratës tatimore me bizneset duke rikonceptuar administrimin dhe menaxhimin fiskal. Në vijim do të synohet konsolidimi i këtyre mekanizmave dhe zgjerimi i kategorive të ndryshme të bizneseve që përfshihen në to, me qëllim shtrirjen kapilare të këtij sistemi. Një sfidë tjetër përtej digjitalizimit dhe rritjes së denoncimit të rasteve korruptive janë edhe hartimi dhe zbatimi i politikave nxitëse për denoncimin e rasteve korruptive, zvogëlimin e tij në sektorët nevralgjikë në luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave.
 - Transparenca për pronarët përfitues dhe mbajtja e regjistrit të llogarive bankare i ka dhënë fund epokës së anonimitetit, duke shtuar vigjilencën për përdorimin e pasurive të tyre për qëllime të paligjshme të pastrimit të parave. Do të synohet konsolidimi i këtyre sistemeve, përmes rritjes së përqindjes së regjistrimeve të bizneseve dhe organizatave jo qeveritare në këto sisteme.
 - Përgjatë vitit 2021 është shënuar ulje e ndjeshme e kohës së pritjes në shërbimet e Kadastrës. Megjithatë, mbeten ende për t'u adresuar në vitet në vijim sfida madhore e përmirësimit të cilësisë së shërbimeve kadastrale dhe digjitalizimit tërësor të sistemit për të pakësuar maksimalisht çdo hapësirë korruptive, përmes një sistemi të qartë monitorimi të riskut.
 - Shërbimet digjitale të transportit rrugor janë sot një dëshmi e qartë e shndërrimit digjital të ofrimit të shërbimeve publike, duke shmangur çdo burokraci dhe tejzgjatje procedurash dhe duke sjellë reduktim të ndjeshëm të kostove të qytetarëve në kohë e para.
 - Mekanizma të rinj denoncimi të korrupsionit janë vënë në dispozicion të qytetarëve dhe bizneseve dhe ato ekzistuese janë forcuar për të mundësuar në praktikë përgjigje institucionale të shpejtë dhe efektive ndaj çdo denoncimi të rasteve korruptive. Më shumë përfshirje proaktive duhet të orientohet në funksion të prodhimit të rezultateve konkrete, për të forcuar besimin e qytetarëve në funksionimin e tyre.
 - Hetimet proaktive dhe operacionet policore në fushën e antikorrupsionit kanë shënuar rritje përgjatë vitit 2021. Efektiviteti i luftës kundër korrupsionit dhe identifikimit të rasteve korruptive është rritur edhe në sajë të qasjes së shtuar të organeve të Policisë së Shtetit në bazat e të dhënave. Rritja e kapaciteteve për hetime proaktive të seksioneve të krimin ekonomik do të adresohet në mënyrë shtuar për vitin në vijim.
 - Viti 2021 ka shënuar zhvillime shumë të rëndësishme në drejtim të shkëmbimit të të dhënave përmes bazave të të dhënave të ndërlidhura. Përfitimet e ndërveprueshmërisë përfshijnë rritjen e produktivitetit, uljen e kostove dhe reduktimin e gabimeve, proces i cili do jetë në ndjekje të vazhdueshme edhe gjatë periudhës së ardhshme.
 - Falë sinergjisë me partnerë ndërkombëtarë dhe lokalë, pavarësisht situatës pandemike, janë bërë përpjekje për të rritur mundësitë në luftën kundër korrupsionit. Menaxhimi me efikasitet i riskut në institucionet publike kërkon përcaktimin e linjave të komunikimit dhe raportimit ndërmjet niveleve të ndryshme; ndarjen e rolit dhe përgjegjësinë konkrete të çdo punonjësi; kualifikimin dhe trajnimin e burimeve njerëzore. Mbetet të thellohet ende angazhimi për të përmirësuar kurrikulat e trajnimit mbi antikorrupsionin si dhe mundësimin e specializimit të stafëve përgjegjëse në funksion të forcimit të etikës dhe integritetit, rritjes së transparencës, dhe përfshirjes më të madhe me qytetarët dhe shoqërinë civile.



PËRFUNDIME

Digjitalizimi i ofrimit të shërbimeve publike ka arritur të realizojë një shtrirje të suksesshme dhe funksionim efektiv të instrumenteve, si e-albania.al, C@TS, e-visit, e-depot, U-GOV, ASCAP, Mësues për Shqipërinë, e-Payroll Confirmation dhe Leja elektronike e qëndrimit etj. Shkalla e përdorimit të këtyre mjeteve nga qytetarët për të marrë shërbime publike tregon një përparim të konsiderueshëm në përpjekjen për të ndërtuar një administratë të paprekshme nga korrupsioni.

Ofrimi i shërbimeve të administruara në mënyrë digjitale lejon përmirësimin e zbulimit, monitorimit dhe hetimit të parregullsive, si dhe rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të ofrimit të shërbimeve publike, si në afatet e ofrimit të shërbimit, analizën e kostos për shërbim, kostot e prokurimit etj. Përgjithësisht, ofrimi automatik i shërbimeve publike ul burokracinë dhe hapësirën vendimmarrëse e zyrtarëve publikë. Përmes procesit të automatizimit, një numër në rritje i shërbimeve publike funksionojnë mbi baza vetëshërbimi për qytetarët, çka e bën të panevojshëm kontaktin e drejtpërdrejtë midis qytetarit dhe nëpunësit civil. Shtimi në shkallë të gjerë i shërbimeve elektronike të ofruara e ka ulur burokracinë në mënyrë domethënëse dhe ka hedhur bazat për ndryshimin e kulturës së komunikimit midis ofruesve të shërbimit nga njëra anë dhe qytetarëve e bizneseve nga ana tjetër.

Për shembull, të gjitha kërkesat e qytetarëve për shërbime sociale paraqiten përmes regjistrit të Shërbimeve Sociale dhe përpunohen me anë të sistemit elektronik. Kështu, 64 mijë familje që marrin ndihmë ekonomike e morën shërbimin përmes Regjistrit të Ndihmës Ekonomike. Më tej, personat me aftësi të kufizuar marrin asistencën e aftësisë së kufizuar me dokumentacionin e përpunuar përmes Regjistrit të PAK-ve.

Digjitalizimi i ofrimit të shërbimeve publike ka pasur ndikim të madh edhe mbi informacionin dhe mjetet në dispozicion të Ministrisë së Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorës Kombëtare kundër Korrupsionit, për

shqyrtimin e denoncimeve dhe hetimin e rasteve të nisura/të referuara nga koordinatorët kundër korrupsionit. Një numër në rritje ankesash po merren përmes mjeteve digjitale dhe zgjidhja e tyre, në shumicën e rasteve, mund të ndiqet po elektronikisht nga qytetarët. Gjetjet e raportit tregojnë se digjitalizimi i ofrimit të shërbimeve publike është një instrument premtues për të luftuar korrupsionin, për të fuqizuar qasjet morale, institucionale dhe gjyqësore, për të ulur mbizotërimin e formave të ndryshme të korrupsionit me eliminimin e pjesshëm ose tërësor të ndikimit të faktorit njerëzor në cilësinë, shpejtësinë dhe marrjen e shërbimeve publike.

Për periudhën e ardhshme, qeverisa shqiptare ka si përparësi të sigurojë që qytetarët dhe përfutuesit e tjerë të shoqërisë të zgjedhin më shumë dhe të vazhdojnë të përdorin instrumentet e qeverisjes digjitale, duke forcuar kështu përpjekjet për të ndërtuar një administratë shtetërore të paprekur nga korrupsioni. Për këtë do të duhen përpjekje të reja ndërgjegjësuese dhe vëmendje për të siguruar qasje të barabartë në shërbimet digjitale për segmentet në nevojë të popullsisë.

Duhen bërë përpjekje të mëtejshme për të bërë të mundur një ndërveprim më të mirë të sistemeve digjitale, për të garantuar praninë dhe funksionimin efektiv të protokolleve paralajmëruese për identifikimin e sjelljeve dhe ngjarjeve të parregullta, si mjete ndihmëse për parandalimin dhe ndjekjen penale. Këto sisteme mund të ulin më tej kostot e informacionit, kohës dhe burimeve për kryerjen e hetimeve efektive të rasteve të mundshme të korrupsionit.

Së fundi, në radhë por jo nga rëndësia, shtrirja e suksesshme e shërbimeve digjitale të sistemit publik e bëjnë qeverinë shënjestrën më të madhe të piraterisë informatike. Përballja në mënyrë efektive me kërcënimet ndaj sigurisë kibernetike ka të bëjë jo vetëm me sigurinë kombëtare, por është edhe sfidë për ruajtjen e një shkalle të lartë besimi të qytetarëve në këto instrumente.

